

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

85H-32  
H 22

FERIT  
HALLUNI

*Apeli*



NOVELË

SH-32  
422

FERIT  
HALLUNI



Apeli

NOVELË

1037

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

shëm, fishkëlliu një çast përmes drurëve gjysmë të zhveshur të pllajës. U grind e ulériu te cepi i fjetinës, pastaj rrëshqiti e humbi diku tutje nëpër natë, duke e trashur gjithnjë e më shumë gërvimën e saj rrëqethëse.

Qe një erë brisk e ftohtë, që i shkundi edhe ato pak gjethë që kishin mbetur nëpër degët e lisave. Gëzim Grezda mendoi se tani pylli, ku ai gjente shpeshherë prehje, duhej të ishte shkretuar fare dhe se degët e trungjet patjetër rënkonin heshturazi nga dhimbja e braktisjes së trishtë. Shkretetëri. Shkretetëri e ftohtë, si në Polin e Veriut.

Nga era që frynte dhe nga mendimi që i shkrepit në kokë, ai u tkurr dhe e ngjeshi kokën midis supeve. Në errësirën e thellë të natës, nën jakën e ngritur të kapotës, koka e tij e rrumbullakët humbi thuajse krejtësisht, aq sa ju duk vetëm kapela, strehën e së cilës e kishte ngjeshur deri poshtë mbi sy. Pëshpëriti me yetë, i zymtë në fytyrë;

«Dhe sa kohë na mbeti?... Katërqind e njëzet e pesë ditë. Katërqind e...»

Buzëqeshi hidhur nën peshën e rëndë të ditëve që i kishin mbetur; pastaj, për një copë herë ua qepi sytë të tjerëve. Sami Kaja, si gjithnjë ëndërrues, diç po thurte me atë mendjen e tij prej poeti, duke kundruar me ngulm kurorën ende të gjelbër të kumbullës disa hapa përballë tij. Në të majtë, Qani Shkoza jepte e merrte me nënöficer Malon.

— Të lutem, shoku kujdestar, — thoshte Qaniu. — ma ndërroni kapelën! Ju e shihni dhe vetë, më ri beterr e madhe, sidomos tani që kam qethur flokët.

Nënöficeri, një burrë rrëth të dyzetave, faqekuq dhe me qafën e trashë që i kërcente sipër jakës së xhakëtës, ia ktheu me mospërfillje:

— Hajde, hajde tanë, bëhu djalë i mirë! Qepe kapelen nga prapa, të fë trijë paq në kokë!

— Po silleh si burokrat, shoku kujdestar.

— Oj! Si the, si the?!...

Gëzim Grezda i hoqi sytë prej nënöficerit dhe vështroi për një hop Kolë Rajcën, atë malësor të gjatë, paksa të kërrusur, që po merrej me një zarf të madh blu, të cilin e mbante në duar prej dy-tri orësh. Gëzim Grezdës, papritur e pakujtuar i erdhë për të qeshur. Kolë Rajca po i gëzohëj atij zarfi mu si një nxënës dëftesës me nota të shkëlqyera.

Gëzimi përveshi buzën e poshtme që e kishte ca më të shkurtër nga ajo e sipërmja, u tkurr dhe përsëri zuri të merrei me ditët, madje edhe me orët që i kishin mbetur për të kaluar atje, në lartësi, ndanë pyllit të zhveshur...

Ende nuk kishte filluar apeli i mbrëmjes, po kompania ishte mbledhur aty ku mblidhej zakonisht, në një shesh të vogël, përparrë fjetinës. Drita e zbehtë

e llambës elektrike sipër derës mezi ndriçonte sheshin. Nëpër fytyrat e loddura të ushtarëve lodronin kohë pas kohe dritë-hije kalimtare, që u jepnin pamjeve të tyre një notë serioziteti të pa kapshëm. Duheshin edhe pesë minuta që të fillonte apeli, kurse komandanti i kompanisë nuk kishte ardhur. Ai vinte zakonisht në orën fikse. Ky ishte një zakon të cilin nuk e prishte kurrë.

Ndërkohë, ata prisin. Dhe kjo pritje përsëritez rregullisht, çdo natë, në të njejtën orë dhe në të njejtin vend, pa as më të voglin ndryshim. Megjithatë, në vetvete apeli ruante kurdoherë diçka solemne. diçka krenare, diçka që i lidhte ata edhe më shumë me popullin, me familjen, me shokun, me tokën. Atduheu kërkonte që biri i tij, ushtari, të ishte çdo herë aty, në rresht, dhe gjithnjë i gatshëm.

- Sa është ora, Adrian? — pyeti Gëzim Grezda.
- Nëntë pa katër minuta.
- Pa katër?!...

Si të qe kujtar për diçka të rendësishme, Gëzimi nxori një çast kokën mbi jakën e ngritur të kapotës, pastaj nxitoi e bëri disa hapa përbara, derisa u gjend pranë trungut të njomë të kumbullës. degëzat e së cilës përkundeshin nga era. Me një lëvizje të shpejtë, hoqi me biçak një vijë mbi lëkurën e ndritshme të atij trungu të njomë dhe thirri i gjallëuar:

- Hej, iku dhe një ditë, shokë!

Sami Kaja e pa dhe lëvizi i habitur. Aty për aty, ai nuk e kuptoi qëllimin e Gëzim Grezdsës. Më parë atë shenjë ai e bënte në rripin e mesit çdo ditë dhe me kujdes të veçantë, po shokët i patën folur, ndaj hëpërhë kishte hequr dorë. Tani qe kujtar dhe po e niste rishtas në atë trung peme.

— C'pate, «poeti» im i dashur?! — ia ktheu Gëzimi Samiut. — Mos ta prishi kush frysëzimin?

Po tjetri iu përgjigj serioz:

— Mos e prek më kumbullën!

— Ou, e pse? Një vijë e hollë s'i bën gjë asaj. Apo jo, o Kolë? Ti je malësor dhe e di më mirë nga unë dhe nga ky poeti ynë.

Dhe pa pritur përgjigje, Gëzim Grezda qeshi si duke u tallur.

— Nuk është puna te bima, po te lakrat që ke ti në kokë, — tha Samiu i përbajtj.

— Ou!... Me gjithë mend e ke?

— Si kujtovë! Oj, këndon të shfaqësh vetëm mërzitjen duke gërvishtur gjithandej padurimin tënd të çuditshëm!

Gëzimi u kthyte nga të tjerët dhe vazhdoi:

— E dëgjuat poetin? Na kënaqi, hë?

— Ç'i zbardh dhëmbët! Ai mirë të thotë! — ia pri-ti Qani Shkoza. — Aikoma ti me ato të tuat? Fiasko që fiasko dashke të mbetesh!

Gëzim Grezda u inatos në çast nga nofka që Qaniu i kishte ngjitur para dy muajsh. Deshi t'ia kthente ashpér, po nuk arriti, se erdhi Kujtim Hysi, komandanti i kompanisë. Ata u rreshtuan përmjëherë, secili në vendin e vet. Kujtimi u hodhi një vështrim të menduar, pastaj nisi apelin:

— Adrian Beli!

U duk sikun era reshti nën pushtetin e zërit të plotë e të prerë të komandanit të kompanisë. Dëgjo-hej vetëm shushurima e lehtë e gjethive që binin.

— Këtu!

— Bardh. Pepa!

— Këtu!

— Bilbil Krasta!

— ...

Heshtje. Nuk u përgjigj asnjeni. Komandanti ngriti sytë dhe vështroi rrreshtat e kompanisë. Përsëriti emrin e ushtarit.

— Kë-këtu!

Ishte një zë i ulët, aq sa mezi u dëgjua, zë i shqetësuar. Kujtimit i ra ndër mend pse Bilibili përgjigjej në atë mënyrë. Atë ditë, kompania kishte zhvilluar qitje luftarakë dhe nga tri goditjet, ai ushtar nuk kishte realizuar asnjérën. Dhe kjo pati ndodhur vetëm nga një pakujdesi e vogël, nga mosgradimi në rregull i shënjestrës.

Kujtimi e donte Bilbilin. Ai ishte fytyrëqeshur, më pamje gati si prej fëmije. Tregonte për të afrim e përkujdesje si prej vëllai të madh, ndoniše edhe vetë nuk ishte më tepër se njëzet e shtatë vjeç. Uli sytë mbi evidencë dhe lexoi:

— Qani Shkoza!

— Këtu!

— Kolë Rajca!

— Realizoi shkëlqyeshëm detyrën, — kumboi aty për aty një zë tjetër, thuajse në një kohë me zërin e Kolës.

— Çfarë?

Komandanti i kompanisë ngriti kokën lart.

Nuk iu përgjigj njeri. Pyetja e tij imbeti një copë herë pezull në hapësirë. Nuk ishte bërë zakon deri atëherë që gjatë zhvillimit të apelit të jepeshin përgjigje të tjera veç fjalës «Këtu!». Kurse tani... Kush ishte ai që kishte folur? U përpoq ta dallontë nga zëri. Dhe e dalloji. Ishte Sami Kaja. Vetëm atij mund t'i shkonte nëpër mend kjo gjë, Samiut.

Kujtim Hysi buzëqeshi dhe aty për aty vendosi që t'i tregonte për këtë ngjarje sekretarit të partisë

dhe komisarit të batalionit. Me këtë mendim në kokë, vazhdoi të bënte apelin në atë natë nëntori të ftohtë dhe me erë.

2

Me t'u larguar komandanti i kompanisë, Kolë Rajca ndjeu të pushtohej sërishmi nga mendime të gjëzuara. Një rrëqethje kënaqësie ia përshkoi gjithë shtatin, ia gjallëroi fytyrën dhe ai pati dëshirë të rriinte sadopak me vetveten. Qe një nga ato çaste, kur nga lumturia burri kthehet në fëmijë. E kishin ndeuar në mënyrë të vegantë faqe të gjithë shokëve. Pas afro mëntë muajve shërbim nën armë, po niderohej kështu pér herë të parë.

Iu bë sikur dëgjoi edhe një herë zërin e plotë e të prerë të komandantit të kompanisë. Dhe pas tij përgjigjen e shokut:

«Realizoi shkëlqyeshëm detyrën...»

Solli ndër mend zërin e Sami Kajës dhe buzëqeshi me vete. Kishte dhe të tjerë, predhat e të cilëve kishin goditur mu në shenjë, po vetëm pér atë ishte bërë ky përjashtim. Hej, Sami Kaja!...

Priti sa të futeshin shokët në fjetinë.

— Ku vajti Kola? — pyeti Adrian Beli me të ardhur.

— Ka rënë në hall «Harusha»! — tha Qani Shkoza pér Kolë Rajcën. — Nuk di kujt t'ia dërgojë fletën e nderit, tatës apo së dashurës së zemrës. Kjo është çështja.

Kolë Rajca u mënjanua ca dhe e vështroi kushti pér të satën herë zarfin e madh blu, të cilin e mbante nëpër duar që nga koha kur ia kishin dhënë. Ndjeu

ta sulmonte një valë e re gjëzimi, të cilën rrallëherë e kishte provuar. Në jetën e tij të re kishte pasur edhe ditë të tjera të shënuara, por si kjo e sotmja jo. Kjo ishte një ditë e veçantë. Në gjithë qenien e tij sikur që futur një dritë e butë, e ngrohtë dhe e ëmbël, që ia ledhatonte pareshtur sedrën prej malësori. Ai as që e vinte re erën që vazhdonte të fishkëllente përmes drurëve të zhveshur të pyllit, duke u grindur e shamatuar me një teneqe në cepin e fjetinës. Atë zarf të madh blu ia kishte dhënë vetë, me dorën e tij komissari i batalionit. Atje, ndanë pozicioneve të zjarrit, në prani të gjithë repartit, pasi sekretari i partisë, Luan Sava e kishte parë me sy të qeshur. Dhe tan, brenda atij zarfi fshihej e gjithë krenaria e tij, kënaqësia e tij. Një filetë nderi.

«Do t'ia çoj tatës, — tha pas pak më vete Kola. — Tata do të gjezohet. Tata do ta vendosë në një korinizë me xham, atje përsipër oxhakut... Po Diella...?»

Papritur e pakujtuar, ndjeu se u turbullua. Fytyra iu mbush me gjak të nxeh të dhe për disa çaste e harroi fare zarfin. Pse i ra ndër mend ajo...?

Kujtesa mori rrugët e fshatit të lindjes.

«Si shumë herët i kë dhënë rrugë zemrës, or ti, Kolë Rajca! — i pati thënë një mëngjes mënkryetari i kooperativës, xhaxhai i Diellës. — Mos e lodh veten kot në punë që s'japin berëqet! Diella nuk është përtty.»

Malësori i ri qe shtangur në vend nga goditja. Ish-te skuqur në fytyrë dhe mbi supe pati ndier peshën e rëndë të maleve. Dhe gati sa s'i kishte thënë: «Sa për të parën, zemrës e mendjes u ka hapur rrugë Partia dhe e drejta më thotë të mos dëgjoj asnjë këmbanë tjetër, kurse për të dytën... e ka në dorë Diella ta zgjidhë atë punë.»

Po Kola nuk pati folur. Fjala i qe lidhur në grykë e i ishte dukur sikur për një çast ia kishin mbytur fjalën disa guralecë të vjetër malesh. Guralecë me myshk. Mos vallë ky ishte vërtet fundi i atyre vështrimeve të heshtura, por të ëmbla që ata të dy, Kola e Diella i hidhnin njëri-tjetrit sa herë që rrinin bashkë e takoheshin rrugëve të fshatit në kalim? Jo. Kola e ndiente thellë që edhe Diella e donte. Pra, ç'kérkon te ky nënkyretari?!

Solli ndër mend atë ditë kur të rinjtë e fshatit u mblohdhën në kuvent dhe vendosën njëzëri që gratë dhe vajzat të hiqnin rubat nga koka. Rubat e vjetra të maleve. E para që u ngrit dhe e hodhi rubën mu në sy të të gjithë shokëve dhe shoqeve qe Diella. Me sytë që i shkëlqenin, ajo e pati shikuar Kolën drejt e në bebëza, si t'i thoshte: «Hë, si të dukem tashti?».

Dhe ai i qe përgjigjur me vështrimin e vet:

«Si rrezja e diellit kur bie në ujin e pastër të burimit.»

Pas tri ditësh, që nënkyretari i kooperativës i kishte thënë ato fjalë, Kola e takoi përsëri Diellën në pyllin me mare, sipër fshatit. Po shkonte ushtar dhe e donte patjetër fjalën e saj. Po Diella nuk foli. Ajo vetëm po hoqi me kokë se do t'i shkonte në takim. Ishte një po him që e mbushi me gjak fytyrën e djaloshit malësor. Kola e priti gjithë atë pasdreke Diellën, por ajo nuk erdhi që nuk erdhi. Mos ndoshta nuk e kishte kuptuar drejt atë, apo ai, xhaxhai i saj... U shqetësua, ndjeu t'i priteshin gjunjët, se iu kujtua çfarë i kishte thënë nënkyretari: «Si shumë herët i ke hapur rrugë zemrës; or ti, Kolë Rajca! Diella nuk është për ty. Zakoni e do që për këto punë, malësori t'ia mësyjë fshatrave përtet. A kaq shpejt e harrove zakonin, a?».

Paškérka alkoma njeréz që i ushqejnë zakonet e vjetra tē maleve, apo ky xhaxhai i Diellës ka ndonjë hall tjetër?

Kolë Rajca u inatos keq me «malet», duart zunë t'i dridheshin, e, pa ditur ç'bënte, goditi fort me çifteli trungun e një arre tē egër. Çiftelia u thye dhe ai nuk e takoi më Diellën. Pas pesë ditësh shkoi ushtar. Ai ishte ndoshta i vetmi malësor që nuk e kishte marrë me vete në ushtri çiftelinë. Po në repart nuk e dinin se cila ishte arsyaja. Ai nuk i shkruante Diellës dhe ajo s'bënte zë. Po Diella jetonte në një skutë tē thellë tē zemrës së tij, si një yll që regëtin pareshtur në largësi, herë fort, herë zbehtë.

Kolë Rajca mezi u shkëput nga kujtimet dhe vështroi përsëri zarfin blu. «Do t'ia çoj tatës, për besë, — tha kësaj radhe pa mëdyshjë. — Tata do të gëzohet. Tata do ta vendosë në një kornizë me xham përsipër oxhakut, aty ku ishte dikur çiftelia».

Nga mendimet e shkëputi zëri i Qani Shkozës:

— Hej, «Harushë», ku e ke mendjen?

— Hë?! — tha malësori i hutuar. — Ti, Qani je?

— Nga koka gjer në këmbë, një metër e shtatëdhjetë centimetra, — qeshi tjetri. — Ç'po bën vetëm këtu?

— Hiç, — vuri buzën në gaz Kola. — Po mendoja për... — Gati sa s'i tha që po mendonte për Diellën.

— Léri mendimet tashti, «Harushë»! Shko e fli, se je lodhur!

— Ani, mirë! — tha Kola. — Po ti?

— Unë kam shërbimin. Hajt pra, ma bëfsh natën qumësht tē ëmbël!

Qani Shkoza u largua duke i shkelur syrin Kolës. Ky e ndoqi një copë herë me sy, derisa ai humbi në për niatë. «Pasha besën, djalë ma tē mirë nuk ban ma

nana! I shkathët e i pastër si rrëke mali», — tha me vete pér Qaniun.

Ndenji dhe pak aty, duke menduar pér fshatin, pér prindërit dhe pér Diellën, pastaj u nis drejt fjetinës.

Kolë Rajca hyri ngadalë në fjetinë, duke pasur kujdes të mos zgjonte njeri. Posta e fjetinës, një ushtar i shkurtër kokëtullë, e shikoi Kolën me kureshtje. Kola kujtoi se ai deshi t'i têrhiqte vëmendjen që të mos bënte zhurmë, ndaj ngriti lart pëllëmbën e tij të madhe si putër ariu, si t'i thoshte tjetrit: «Mos ki merak, or ti, nuk baj zhurmë. E kam në kujdes vetë.»

Shokët ishin shtrirë të gjithë nëpër shtretër dhe nuk ndihej pothuajse asgjë, veç një pëshpërimë që vinte prej fundit të fjetinës. Ngjante sikur dikush recitonte me zë fare të ulët vargjet e një poezie. «Samiu! — tha Kola me vete. — Samiu ban vjersha, vjersha të bukura».

Thithi duhmën e ngrohtë të trazuar me erën e djersës, pastaj, duke ecur lehtë, dëgjoi papritmas një zë që thirri: «Këtu!» U kthyesh përnjëherësh prapa dhe, pas pak, buzëqeshi me vete. Një ushtar kishte folur në gjumë. Atij iu kujtua në çast se diçka e tillë kishte ndodhur edhe gjashtë muaj më parë.

Kolë Rajca ecte ngadalë drejt shtratit në fund të fjetinës. Pas pak u pengua te një palë këpucë, që nuk ishim vënë në radhë me të tjerat. Dikush e pa dhe qeshi me zë të ulët, po Kola nuk i dha rëndësi. Ai e kishte mendjen te Diella dhe tek ai nënkyetari, xaxhia i saj. Eci më tej dhe shikoi edhe një herë zarfin e madh blu. Të nesërmen, shumë-shumë të pasnësërmen, do ta postonte. «Pér 'besë, do t'ia çoj nënkyre-

tarit të kooperativës! — tha me vete. — Ndoshtha kështu i bie në dorë edhe Diellës, Ajo do të gëzohet».

Nuk arriti t'i jepte fund mendimit. Papritur, ndjeu t'i fluturonte zarfi nga duart. Mbeti një grimë herë i hutuar.

— Oj, — ia bëri duke vështruar majtas, djathtas. — Kush ma mori?!

Asnjeri nuk iu përgjigj. Prapa shpinës së tij dikush përshpëriti ca fjalë, prej të cilave Kola nuk kuptoi asgjë. Ur inatos dhe iu drejtua Gëzim Grezdës, që atë çast u ngrit ndenjur mbi shtrat, dhe zuri ta shikonte si me tallje.

— Ti, Gëzim?... — e pyeti me të shpejtë.

— Unë!... Çne!

Kolës i erdhi inat. Ai nuk i zuri besë Gëzimit. «Ky i ka gjuhën dhe dorën të gjata në lojnat, mendoi i shqetësuar. Ai i binte shpeshherë më qafë. Sa herë Kola ulej të shikonte programet e televizorit, dhe kur në klasë binte errësira, Gëzimi ia megrte kapelën nga koka. Po dhe kur hynte Kola në mensë, Gëzim Grezda thërriste: «Hej, hapuni, hapuni! Po vjen furra «Hofman!». Muço, të keqen, — i thoshte pastaj kuzhinerit, — nxirrna një tenxhere me fasule!» E këto Kolës nuk i pëlqenin. Skuqeji në fytyrë, turbullohej, por e përbimbante veten. Vetëm një herë, s'dihet se si i kishte thënë Gëzimit: «Or ti, Shih rrugën e mos nguc grerëzën me krande, se, përbesë, nguc të zezen tën-de! Po si përgjigje pati marrë një të qeshur tallëse. Ja dhe tashti! Gëzimi po e mërziste me ato shakatë pa kripë. Kola ndjeu ta humbiste durimin dhe për një çast harroi se të tjerët flinin. E ngriti zërin e iu hakërrua:

— Po kush ma mori, atëherë?

— Unë! — përshpëriti një zë i mekët, të cilin Kola nuk e dëgjoi dhe i tha prapë Gëzimit:

— Or-ti, mos luéj, ma jep këtu zarfiin!.

— Pér nder, je i lezetshém! C'ke, ore, me mua!?  
Nuk e dëgjon Adrianin?!

— Adriánin?!

— Kolë! — tha në çast ky i fundit. — Ta mora  
unë. Thashë ta shihja një herë. Kë katër orë që e  
mban nëpër duar dhe nuk e lëshon!

— Sille këtu!

Pa thënë asnje fjalë tjetër, Kolë Rajca zgjati do-  
rën dhë mori zërtin. Dukej që ishte inatosur keq.

— E kuptove tashiti se kush ta kishte marrë? —  
S'iù ndenj pa folur Gëzim Grezdës. — Mua, pér vete,  
— shtoi duke shtrembëuar fytyrën e tij rrumbulla-  
ke, — nuk më hyn në punë fleta e nderit. S'bëhem fort  
merak pér të. Edhe shtatë të më japid nga ato, s'ma  
bëjnë qejfin sa një triditësh leje.

Kola nuk foli. Po një tjetër aty pranë mezi e  
përbajti të qeshurën.

— E kush të jep leje ty, o i gjorë! — Ishte zëri i  
Bardh Pepës.

— E pse të mos më japid? Apo nuk ia bëra fyty-  
rën fërtete atij imperialistik a revizionistik në tabelë!  
Hahaha...

— Qëllove mirë vërtet, po kjo nuk është kryesore,  
foli përsëri Bardh Pepë, sekretari i rinisë së kom-  
panisë.

— E kush nia qenka, sipas teje, kryesorja?

— Njeriu, — tha Bardhi.

— Aa, tani më mbushe mendjen! Bravo, pér nder,  
bravo! Nuk e dija!

— Po ta dije, nuk do të silleshe...

— Hej, ju atje, mbani qetësi! — ushtoi befas një  
zë. — Tani e gjetët kohën të bëni muhabet!? Ne po  
fletë! Jemi të lodhur.

— Fli, biri i nënës, — u dëgjua një zë tjetër, —  
Nina, nana! Fli!

Kurrë nuk kishte ndodhur kështu gjer atëherë.  
U ndien hapat e nxituar të postës së fjetinës, që u  
ngut të vendoste qetësinë.

Kolë Rajca u zhvesh dhe u shtri me kujdes në  
shtrat. U rrrotullua një copë herë nëpër çarçafët e  
freskët dhe pas pak e ndjeu se atë natë s'do të vinte  
gjumë në sy. Kështu i ndodhët gjithnjë, kur sillte ndër  
mend Diellën, ose kur diçka nuk i shkonte në rregull.

Zuri të mendonte sérish për fletën e nderit, të  
cilën do t'ia dërgonte të nesërmen atij nënkyretarit të  
kooperativës, për Diellën. që nuk erdhi pasdite të bi-  
sedonte me të, për çiftelinë e thyer dhe përsëri për  
nënkyretarin, për Gëzim Grezdën. Qepallat dalngada-  
lë po i rëndoheshin, megjithatë gjumi, që do ta shpë-  
tonte nga ato mendime, nuk po e zinte. Duke u për-  
pjekur t'u shmangej mendimeve, i zunë veshët paprit-  
mas një si fëshfëritje gjethesh në pyll. U përqëndrua  
dhe dëgjoi:

— Ma lexo dhe një herë, Sami! — tha zëri i parë.

— Jo, shokët po flenë.

— Lexomë, të paktën, vetëm strofen e fundit!

Heshtje. Samiu nisi të lexonte:

...Dhe kështu, ai mbeti midis malesh,

I ndezur yll ndanë pozicioneve.

Si një shkëmb i paepur, si një zjarr rrebesch.  
në zemrën dhe tytën e pashuar të batalioneve.

— Hë, të pëlqen? — pyeti ai pas palk.

— Posi.

— Kurse mua... nuk më ngroh.

— Léri ato e mos e zgjat! Dërgoje që nesër për  
botim.

— Kam frikë, — tha Samiu. — Poezinë e parë që dërgova nuk ma botuan. Prandaj Gëzimi ka ca të drejtë, kur tallet nganjëherë me mua.

— Këtë e ke të bukur. Dërgoje, dëgjomë mua.

Kolë Rajca mbajti vesh edhe pak, por nuk dëgjoi gjë më. U kthyё në krahun tjetër. I mbylli sytë fort dhe u përpinq të flinte.

Duhej të ishte mezi i natës, kur dëgjoi një zhurmë të lehtë hapash, që ia përzunë përfundimisht gjumin nga sytë. U kthyё nga e majta dhe pa Qani Shkozën, që po i afrohej lehtazi shtratit të tij. Deshi t'i filiste Qaniut, por hoqi dorë. Si do ta kalonte gjithë atë natë pa gjumë? «Qaniu është i lodhur, — mendoi. — Le të flejë». Vështroi në heshtje profilin paksa krrut të Qaniut, kokën e tij të qethur vezake, që humbiste thua se krejtësisht nën kapelën e madhe dhe i erdhì për të qeshur.

Qaniu u zhvesh dhe u mat të shtrihej.

— S'ke fjetur akoma, Bilbil? — pyeti shokun në shtratin majtas.

— S'po më zë gju-gjumi.

— Pse?

— Ku-ku ta di unë. Më çajnë kockat. Pastaj, të them të-të drejtën, ajo pu-puna sot në po-poligon...

— Harroje! Gjëra që ngjasin.

— Më vjen të pëlcas nga inati. Tu-turpërova veten dhe ko-komandanitin. E di, kur isha në po-pozion...

— Fli tashti! — e ndërpreu Qaniu.

Kola preku me gishtérinj fletën e nderit nën jastëk. Ajo i solli ndër menç pëzicione e zjarrit, shungullimën e krismave dhe për një copë herë iu duk sikur ajri i fjetinës u mbush me erën e barutit të djegur.

Biseda midis sekretarit të partisë, Luan Savës dhe Nasi Vodicës pati mbaruar. Nasi Vodica u ngrit më këmbë dhe gati sa s'e çiku me kokë tavanin e zyrës. Ishte trupgjatë, me ballë të gjerë e të rrudhur dhe me flokët e dendur të thinjur thuajse krejtësisht. Sytë e zinj, si dhe ngjyra e rreshkur bojë gruri e fytyrës, sajonin një kontrast të prerë me leshrat e zbardhura. Pamja e tij, zakonisht e rreptë dhe e menduar, fë linte përshtypjen e njeriut që kthehet nga lufta, kurdoherë me shprehjen e fitores në sy, kurdoherë me bindjen e njeriut që është i gatshëm të rikthehet përsëri atje, po ta lypë nevoja.

Luani, duke e parë Nasi Vodicën ashtu të bëshëm dhe me shikim të menduar, tha me vete: «Do ta ruajë vallë edhe sonte komandanti zakonin e tij të mirë? Do takohet si gjithnjë me ushtarët, të bisedojë me ta?»

Nasi vinte herë pas here aty, në kuotën treqind e një dhe me atë zérin e tij paksa të ngjirur, për shkak të një laringiti të vjetër kronik, shtrohej në biseda të gjata me ushtarët. Lufta Partizane, strategjia dhe takтика e saj, ishin tema më e preferuar e atyre bisedave, për të cilat ai dukej sikur vinte enkas. Por, nuk qe plotësisht kështu. Ai në radhë të parë kishte për qëllim të kryente detyrën. Ishte nga ata që s'të falin fijen e flokut në punë.

— Atëherë, mendoj të mos humbasim kohë, — tha ai pas pak, duke shprehur në tonin e tij një notë serioziteti të vegantë. — Mblidhni oficerët! Ah, mos keni këtu një furçë?

Sikur të thoshte mos kishin nëpër xhepa ndonjë bombë, ata nuk do të lufteshmë aq, sa u habitën nga

ajo pyetje: Ç'i duhej furça në mes të natës dhe, veç kësaj, në ato rrithana?! Sekretari i partisë e vësh-troi në bebëza. Çlirim Shpati, komandanti i batalionit, buzëqeshi dhe i uli sytë poshtë. Çizmet e komandantit të njësisë ishin ndotur me baltë.

«Ka ecur më këmbë», — tha me vete Çlirim.

I sollën furçën dhe ai u pastrua shpejt e shpejt. — Nisemi, shoku Nasi? — pyeti sekretari i parti-së.

Tjetri pohoi me kokë dhe ata dolën pa folur nga dhoma. Pas një gerek ore, të gjithë oficerët ishin mbledhur në zyrën e vogël të komandës, ku prej një kohe nuk qenë parë aq njerez. Ata e kuptonin se ardhja e komandantit të tyre në atë orë të natës do të kishte të bënte patjetër me ndonjë provë gatishmë-rie ose,.. me ndonjë stërvitje të madhe, aspak të zakonshme. Në jetën e tyre, stërvitjet, lëvizja ishin si të thuash eliksiri që u ripërtërinte pareshtur forcën, dijen, bashkimin... Dhe nga kjo ata e priten urdh-rin si çdo herë, seriozë në fytyrë dhe me atë gjak-ftohtësinë e zakonshme të njerëzve, të cilët janë më-suar me sakrificën dhe të papriturat. Vetëm njëri prej tyre diçka murmuriti me vete. Ky ishte Kujtim Hysi, komandanti i kompanisë së dytë të batalionit të lar-tësisë. Para dy orësh ai kishte biseduar në telefon me Verën, të shoqen dhe i kishte premtuar që të nesërm-en, aty rrëth drekës, do të ishte në shtëpi. Ata kishin gati rrëth dy muaj pa u parë me shoshoqin dhe i pati marrë malli. Veç kësaj, nga dita në ditë Vera priste që të lindte dhe, ai kishte dëshirë t'i gjendej pranë. Për këtë pati biseduar edhe me komandantin, kurse tashti...

«Ajo me siguri do të habitet që nuk e mbajta fjalën», tha me vete Kujtimi.

Pastaj e flaku tej atë mendim dhe u përqendrua në detyrën që i priste. Komandanti i batalionit foli me zë të prerë:

— Mund të fillojmë, shoku komandant?

Nasi Vodica bëri «po» me kokë, pastaj hoqi kapelën. Në çast, në zyrë u ndje një lëvizje karrigesh. Çlirim Shpati hapi hartën mbi tavolinë. Të gjitha vështrimet u ngulën mbi të. Në sipërfaqen e saj, diku qartë dhe diku të kapérthyera me njëra-tjetrën, dukeshin ca shenja e vija të kuqe e të kaltra. Për një sy të pamësuar me të tilla pamje, ato vijëza e shenja do të dukeshin sigurisht si hieroglife, apo konglomerat hieroglifesh, të cilat i kishte hedhur aty një dorë e kujdeshshme. Po nuk qe kështu e vërteta. Vijat e shenjat ishin «lufta», ose më saktë ideja e luftimit. Secili nga oficerët mundi të kapte në përbërjen e tyre diçka nga mendimi i komandës së batalionit për manevrën e ardhshme dhe e përfytyroi veten në krye të rreshtavei.

Shigjetat e kuqe, që përfaqësonin skuadrat, toqat dhe kompanitë, u dukën sikur lëviznin në drejtim të ndryshme. U shtynë përpara me forcë, diku u ndalën në trajtën e një gjysmëharku, duke u ndeshur «për jetë a vdekje» me ato të kaltrat, të cilat tentonin të zgjateshin drejt tokës sonë.

Atë çast u dëgjuau zëri i komandantit të batalionit:

— Sot, në orën 20.00, sipas orës operative, të kaltrit (armiqqtë), me forca të mëdha numerike dhe teknike, tentuan me një sulm të befasishëm të pushtonin luginën matanë kuotës 702, me synim që të krijojnë atje një plasdarm të favorshëm për veprime të mëtejshme agresive kundër territorit të vendit tonë...

Në zyrë u bë heshtje. Secili nga pjesëmarrësit

mori një pamje serioze. Në fytyrat e tyre lexohej gatishmëri, vendosmëri, guxim e trimëri për t'u hedhur menjëherë në zjarr sikur me të vërtetë armiku të trokiste në derë.

Komandanti i batalionit vazhdoi:

— ...Në këto kushte, komanda e batalionit, me miratimin e Partisë, merr vendimin që të organizojë menjëherë mbrojtjen aktive në qendër dhe në krahët dhe me tri kompani të përqëndruara në rajonin e kodrave të Skënderasit, në bashkëveprim me çetën territoriale, të kryejë kundërgoditjen deri në asgjësimin e plotë të kundërshtarit. Për këtë...

Kujtim Hysi u tendos. Atij iu kujtuan në çast kompania, apeli i mbrëmjes, zëri që ishte përgjigjur në vend të Kolë Rajcës dhe ndjeu rëndësinë e ngrohtësinë e asaj fjalës «këtu», që shqiptohej kurdoherë solemnisht brenda rreshtave.

U kujtua që duhej të shkruante dhe nxori bllokun e shënimeve nga çanta. Komandanti i batalionit tanë do t'i jepte secilës kompani detyrën dhe doemos, atij i duhej të merrte shënimet përkatëse. Po tamam atë kohë kur po bëhej gati të shkruante, dëgjoi zërin e Çlirim Shpatit:

— Hiqe bllokun, shoku Kujtim! Përpiku t'i mbash mend të gjitha dhe t'i riprodhosh në çastin e duhur!

Ai u skuuq në fytyrë. Nuk qe mësuar t'i tërhiqmin vëmendjen në sy të të tjerëve. Veçanërisht vështrimi i Nasi Vodicës iu duk sikur e zhbiroi tejpërtej. U huitua, po e mori veten shpejt dhe e ndjeu se prej tij kërkohet të komunikonte gjallërisht me idenë e luftitimit që po paraqitej.

— Për këtë, — vazhdoi komandanti i batalionit me atë zërin e tij kumbues, që tingëllonte si thirrje, — kompania e parë, me drejtimin nga Lëndina e Du-

shqeve, do të kryejë marshimin me itinerar: Kuota treqind e një, Varrji i Nazikut, Qafa e Kodrës së Bar-dhë. Kompania e dytë...

Me të mbaruar shpjegimin e detyrës, komandanti i batalionit ngriti sytë nga harta dhe ua qepi oficerëve.

— Qartë? — pyeti ai.

— Si urdhëron! — iu përgjigjën të gjithë njëherësh.

Nasi Vodica u ngrit në këmbë, bëri dy-tre hapa përpëra tavolinës ku shtrihej harta dhe po vështron-te me radhë oficerët përreth tij.

Sekretari i partisë, Luan Sava, vuri buzën në gaz. Në fytyrën e Nasi Vodicës ia vuri re keqardhjen që nuk mundi të takonte ushtarët, siç bënte nga hera kur vinte në kuotën treqind e një.

#### 4

Nata qe pus e errët. Frynte erë dhe piklonte shi. I shoqëruar nga komandanti dhe komisari i repartit, Nestor Dine, Nasi Vodica, ndaloi papritur mu në mes të sheshit të pjerrët të kuotës treqind e një dhe përkuli kokën. Akrepat fosforeshentë të sahatit tregonin një pa dhjetë minuta pasmesnate.

— Kemi dhe pak kohë, — murmuriti ai. — Në orën një fiks. Pastaj ai shikoi lart kupën e zezë të qiellit prej nga vazhdonin të binin piklat e shiut. Era përplasej pas trungjeve të lisave dhe kohë pas kohe kiste me ca fishkëllima rrëqethëse. Nga veriu tutje bu-bullonte. Nga fjetina e gjatë dhe e heshtur, që ngri-hej midis ca lisave të rinj, mezi shquhej një dritëzë

ë mekur, që e tregonte godinën larg, shumë larg, diku në skajin më të thellë të asaj nate të errët.

Nasi Vodica u kthyte nga komandanti i batalionit dhe seç murmuritë. Mé sa dukej, kërkonte me sy borizanin. Dhe ja, metali i vërdhë i borisë ndriti njëzet-tridhjetë hapa larg. Silueta e Nasit, e lartë dhe e drejtë si një lis, me atë kokën e bardhë si të mbështjellë me fasho, i ndolli sërish Clirim Shpatit imazhin e njeriut që porsa ishte kthyer nga lufta.

Për çudi, Nasi nuk pò fliste dhe as po jepte ndonjë shenjë me dorë që të shërbente si sinjal. Ai, i heshtur dhe i menduar, që kthyer me fytyrë nga fshati, ku errësira e matës shpohej nga disa xixëllime të zbehta drithash. Të dukej sikur po përgjonte diçka.

Clirim Shpati i hodhi sytë nga vështronte eprori dhe u përqendrua. Prej fshatit atje në fushë, vinin ca zëra të trazuar. Era i hallakaste nëpër errësirë dhe aty, në lartësinë e kuotës treqind e një, ata sa mezi dëgjoheshin. Vetëm kur era reshti një grimë, u ndje deri diku qartë një zë, i cili ngrihej mbi të tjerët me një kumbim të largët, sikur vinte prej diku, nga thellësia e tokës.

Nasi Vodica u gjallërua.

T'u këndoymë — o, trimave,

që flenë lëndinave!

Dyshek kanë tokën - o,

Jorgan kanë gunat - o...

Që një këngë labe. Cliri mi më komisarin buzëqeshën, ndërsa Nasi zgjati kokën edhe më në drejtim të fshatit, si pér ta dëgjuar më mirë këngën. Dy të tjerët kujtuan se dò t'ia merrte edhe ai këngës. Pér «labçën» kishte «dobësi».

— Ç'bëhet kështu?... — pyeti ngadalë. — Dasmë; duket, hë? — Ju bë sikur dasma për ato rrethana, kur do të niste «beteja», dilit jashtë realitetit. Por, ndryshoi shpejt mendim. Jeta vazhdonte normalisht.

Ukthye buzëgaz nga komisari dhe Çlirim Shpati.

— Dëgjoni? — tha me një zë, ku ndihej qartë kënaqësia. — Njerëzit këndojnë.

— Dasmë, shoku komandant! — iu përgjigj komisari, dhe iu kujtua ftesa që Qamil Riza ia kishte dhënë para dy ditësh.

— E kush martohet?

— Sekretari i rinisë së fshatit.

— Sekretari i rinisë?!

— Po, — shtoi komisari, — i biri i Halil Rizës, që ka qenë komandant i batalionit tonë gjatë Luftës. Të gjitha dasmat e shtëpisë së tij në nëntor i bën ai.

Nasi diç ndjeu t'i vërvonte përbrenda me rrëmbim. Ai sikur i harroi erën edhe shiu, që sa vinte po shtrëngonin më shumë dhe mbajti vesh zérat që këndonin. E përfytyroi veten midis dasmörëve dhe papritur ia mori isos nën zë. Po heshti shpejt..

«Pas pak, të gjithë këta dasmorë do të kthehen në ushtarë, — tha ai me vete. — Edhe Halili vetë... Dhe kënga do të kthehet në pushkë.»

— Po shtrëngon shiu, shoku komandant, — tha Çlirimi, duke iu trembur laringtitit kronik të eprorit.

— Vishni pelerinën!

— Pelerinën?... Ah, po, faleminderit! — foli pa e pasur mendjén. Pastaj ai shikoi edhe një herë orën e iu kthye Çlirimit:

— Jepni sinjalin! — i tha shkurt, me një zë çuditërisht të butë.

Dhe Çlirim Shpati i dha shenjë borizanit. Ky u shkund, bëri dy-tre hapa përpara, e vuri borinë në

buzë me një lëvizje të prerë, dhe në çast kuota tregind e një e humbi qetësinë. Tingujt e mprehtë të borisë ushtuan rrëth e qark, u shkrinë dy-tri sekonda me zërat që vinin nga ana e fshatit, mandej u ngritën mbi të duke pushtuar krejtësisht ajrin e ftohtë e të lagësht të asaj nate nëntori.

## 5

Pas bataresë së atyre tingujve metalikë të borisë, gjatë të cilëve reshti e u mek çdo gjë, edhe era përjashta, edhe zukatja gjumësjellëse e shiut mbi çatinë e fjetinës, edhe lëvizja e hapave të rojës, ngjau sikur dheu u çadiku aty pranë dhe nata e humbi njëherë e mirë pushtetin e saj të zyrtë.

Qe gati një përmibysje, që u jepte krahë mendimit dhe muskujve.

Në fillim u ndjenë disa hapa të shpejtuar, pastaj thirrje «alarm!» dhe në çast lëvizja shpërtheu gjithçka rrëth e rrotull: Ushtarët kërcenin nga shtretërit e ngrohtë ende të përgjumur, po tingujt e alarmit ua kthjellonin menjëherë mendimet. Ndiheshin murmuritje, zëra të ulët, fjalë të përgjysmuara, hapa të nxituar drejt armaturave. Midis gjithë kësaj lëvizjeje, në dukje marramendëse, u dëgjua një zë i hutuar:

— Hej dreq! Po ku më shkoi njëra këpucë?!

Ai që i tha këto fjalë u rrotulla një hop rrëth vetes, dhe, si nuk e gjeti këpucën, iu drejtua i shqetësuar Sami Kajës:

— Eh, ç'u turpërova, or burrë i dheut!

— Shih se mos e kenë jastëk! — ia priti dikush duke qeshur.

— Nën jastëk?!

Ushtari u hutua edhe më.

— Po e ke në dorë, or t'u mbylltë! — i tha Qano Shkoza, duke mbërthyer me nxitim këmbalet. — Nuk e sheh?!

Tjetri u skuq vesh më vesh. E vështroi një herë si me dëshpërim këpucën, që e kishte në dorën e majtë, ofshau dhe zuri ta vishte shpejt e shpejt.

— Skuadra e dytë! — thirri Sami Kaja dhe u nis të dilte nga fjetina.

— Hej, — i tha Gëzim Grezda një ushtari, që nxiti pranë tij, duke i marrë padashur njérën këmbale.

— Ku i ke sytë? Nuk plasi vërtet, që fluturon ashtu si...

Gëzimi po vishej pa u ngutur.

— Më vjen keq vetëm për një gjë, — i tha Adrian Belit, që nxiton te duke mbërthyer në krah çantën e shpinës.

— Për çfarë? — tha Adriani.

— Po shihja një endërr...

— Endërr?! Ama, gjete kohën tashti!

— Ishte e bukur. Sikur te postëblloku i repartit kishte andhur ajo dhe më kërkonte...

Dikush u përplas te një shtrat e gati sa s'u rrëzua. Ishte Kolë Rajca, që po vravonte drejt daljes.

\* \* \*

Pikërisht në kohën kur mbi kuotën treqind e një çdo gjë lëvizte, fshati atje poshtë, në fushë që ngritur i téri në këmbë. Burra dhe gra me armë qenë nisur ca në drejtim të kuotës treqind e një, të tjerë

nga Lëndina e Dushqeve. Në fshat kishin mbetur po-thuajse vetëm pleqtë dhe fëmijët. E vëtmja shtëpi, ndoshta, që ndryshonte nga të tjerat, ishte ajo e das-mës.

Nusja ndjeu në çast të rrëqethura në trup. Vëtmia ia trazoi qëtësinë, gëzimin. Dasma e saj papritur ishte këputur në mes... Në fillim kishte ikur Qemali, dhëndri, pastaj të tjerët, me radhë. Më në fund dhe xha Halili shtatëdhjetepesëvjeçar.

— Po ikën? — i tha ajo Qemalit, në çastin kur ky po:bëhet gati të dilte nga shtëpia.

— Po, — tha ai dhe buzëqeshi.

— Si ndodhi kështu?

— Alarm!

— Do të rrish shumë atje?

— Ku ta dish.

— Mbaje këtë trëndafil me vete!

Nusja mezi e mposhti zyminë në fytyrën e saj të freskët e të bukur. Pastaj i hodhi sërisht një sy dhomës: Tavolina të boshatisura, gota të lëna përgjysmë, karrige të shpërndara andej-këtej, pa pikë rregulli, mandej... Ajo u habit. Si nuk i kishte vënë re!.... Buzëqeshi. Katër-pesë fëmijë tetë-nëntëvjeçarë ishin ulur në krye të tavolinës kryesore, në vendet ku disa çaste më parë kishin qenë dasmorët më të moshuar dhe i trokitnin gotat me njëri-tjetrin, duke imituar të rriturit. Nuses iu çel fytyra. Iu duk sikur dasma e saj vazhdonte përsëri, e pacenuar në harenë dhe gëzimin e saj, veçse kësaj radhe në një mënyrë krejtësisht të re, origjinale. «Fëmijët» pëshpëriti, pa e ndarë gëzin nga buza. Ajo ishte mësuesja e fshatit. Pa te fëmijët jo vetëm nxënësit, po dhe jetën e saj. Lëvizi. Me atë fustanin e bardhë, që ia hijeshonte edhe më shumë trupin e hedhur dhe me atë buzëqeshjen e cil-

ter në fytyrën ngjyrë trëndafili, ajo qe kthyer gati-gati në një simbol.

Iu afroa fëmijëve dhe i përkëdheli. Dasmave saj vazhdonte.

## 6

Kujtim Hysi u dha në krye të kompanisë së dytë, me atë pamjen e njeriut që bëhet gati t'u transmetojë të tjerëve një lajm tepër të rëndësishëm. Serioz te i tendosur, i mbërthyer në rripa, me helmetën në kokë dhe me atë kapotën e gjatë që e tregonte edhe më trupmadh nga çishte në të vërtetë, ai u hodhi një sy rreshtave. Kështu bënte gjithnjë kur dilte në kyre. I shikonte një nga një ushtarët, duke vënë lehtazi bu-zën në gaz, sikur të donte të shprehte kështu besimin që kishte tek ata.

Lëvizi një hap para, pastaj foli. Ndërkaq përnjëherë zunë të dëgjoheshin komanda të prera, lëvizje të mbytura hapash, ndërsa një fashë drite e fortë, e cila luhatej sa andej-këtej, përpiquej të ndriçonte skuadrat, toqat dhe kompanitë. Qe një ndriçim që afrohej dhe iktë, një ndriçim që zgjatej si shirit nëpër hapësirë e që prapë shkurtohej e zhdukej, për t'u rikthyer përsëri pas pak.

«Artileria», mendoi komandanti i kompanisë së dytë dhe u hodhi edhe një sy rreshtave të murmë e të heshtur nga kreu gjer në fund. «Kanë ndryshuar, — tha. — Brenda një viti duket sikur janë pjekur e burrëuar sa e për pesë vjet. Uniforma apo rreshti i ka burrëuar kështu? Të dyja bashkë, ndoshta».

— Kompania! — thirri dhe, ndërsa pritej të vazhdonte, ndali pakujtuar. Vështrimi i mbeti i mbërthyer

në një pikë të veftme nga e djathta. Atë çast, drejt tij po vinte me vrap dikush. Ishte njëri nga ata të fshatit. Po cili? Kur ai u afrua ë i kaloi pranë me nxitim, syri i mprehtë i Kujtim Hysit vuri re diçka që e habiti. «Po ky ku shkon kështu!...» pëshpëriti. Tjetri nuk e kishte veshur kapotën dhe në xhepin e djath-të të xhaketës i zbardhëllonte një trëndafil.

«Si është e mundur kjo?!...» murmuriti i çuditur komandanti i kompanisë së dytë. Pastaj buzëqeshi. U kujtua që atë natë në fshat kishte pasur dasmë. Ush-tari me ternerndafil në xhepin e djath-të të xhaketës du-hej të ishte patjetër dhëndri, Qemal Riza.

— Kompania... — thirri sérish, pasi Qemali hyri në fressht, por kësaj rađhe më zë më të fuqishëm. — Pas meje!...

.....

Natë - pus e zezë. Natë e qullët, kohë e keqe. Me-gjithatë, kompania ecte me një hap. Komandanti në krye ushtarët pas. Llap-lluc, llap-lluc.

— Nga vemi kështu?

— Drejt pozicioneve.

— ...

Kishin gati rreth dy orë që marshonin në drejtim të kodrave, në veriperëndim të kuotës treqind e një. Ishte një varg kodrash, gjysmë të zhveshura, me lartësi thuajse të barabartë, që mbështeteshin në brinjët e njëra-tjetrës me një rregullsi gati të habitshme. Dhe ndoshta sepse në to derdhej shumë djersë, ata e quanin atë vend me emrin që i kishte dhënë Sami Kaja: «Krehri i djersës».

Po të dilje ri qafë, atje ku kompania kishte pozicionët, do të shihje një fushë, dhe përtej saj lumin me ujérat e tij të rrëmbyera. Matanë lumiit ishte një kodër tjetër e lartë shkëmbore. Ajo ngjante më shu-

më me një mal, e me gjuhën e hartave thirrej kuota shtatëqind e dy.

Të gjitha këto, që nga «Krehri i djersës» e gjer te kuota shtatëqind e dy, ushtarët e kompanisë së dytë i njihnin pëllëmbë pér pëllëmbë, se i kishin shkelur kushedi sa herë, në të trija pozicionet: barkas, më gjunjë dhe më këmbë. Kështu, secili prej tyre ishte në gjendje të thoshte me hollësi ç'lloje shkurresh kishte andej, madje edhe ngjyrën e petaleve të luleve që buisnin në pranverë.

Bënte ftohtë dhe binte pareshtur shi. Qerthulli gjysmë i zhveshur i lisave, mes pér mes të cilit lëvizte kompania, nuk i bënte dot ballë shiut të rrëmbyeshëm, i cili lëshohej pjerrtas mbi ushtarët, duke ua bërë ujë rrobat, pajimet. Ishte një sulm i pandërprerë pikash shiu të ftohtë akull, që të hynin thellë, gjerë në palcë.

— Pthu! — turfulloi Gëzim Grezda, duke u dridhur nga koka deri në këmbë. — Shi i tmerrshëm!

— Shi i tmerrshëm! — tha dhe Qani Shkoza dhe ngriti kokën lart. Gati sa s'ia dha këngës. Kështu bënte zakonisht kur binte shi. T'i thoshe në kohë tjetër këndo, do të duheshin disa minuta derisa ai të lironë nöfullat, kurse në shi... S'qe nevoja ta shtyje. Ia mërrte menjëherë vetë. Siç dukej, në këtë mënyrë. «këngëtarë i shiut» sfidonte vetë shiun. Ai deshi ta bënte këtë edhe atë cast. po e kuqtoi dë kjo nuk qe punë me vend dhe heshti. Gëzim Grezda u grind sërisht.

— Sonte do ta kemi punën pisk, dreqi e mori! Nuk do të ishte keq të kishim të paktën kostume impermeabil.

— Edhe këpucë. — deshi Qaniu.

— Eh, sikur t'i kishim!

— Je në vete?! — tha Samiu pa kthyer kokën prapa. — Ç'thua?

— Pse, nuk tē pëlqen ty ikjo?! — u tall me Sami-un Gëzimi.

— Aspak.

— Do tē tē laget poezia, o i shkretë! — i tha me shpoti Gëzim Grezda. — Një tru poetik që laget, thonë, s'bën asnje lek.

Heshti një hop, pastaj iu drejtua Samiut:

— Nuk bëkérka tē «dredhim» një shaka?!

— Léri shakatë! Unë thashë se nganjëherë s'më pëlqeijnë mendimet që tē hipin ty në kokë. Gjithnjë ankoħesh dhe s'di ćfarë kérkon.

— E di ć'kérköj? Diell, neon tē kaltér, paqe. Ma merr mendja që edhe ti, si poet....

— Nëse do paqen, përgatit u më parë pér luftën! — ia ktheu Samiu. — Akoma s'e këmarrë vesh këtë ti?

— Aha, sa pér politikë s'ta kalon kush ty. Edhe komisari tē cmon. Ndoshta dhe në poezi...

Nuk u kuptua qartë se ćfarë deshi tē thoshte atë ċast Gëzimi. Fjala i mbeti papritmas në grykë, se u dégjuu zéri i prerë, e i njohur i komandantit:

«Nga e djathha një grup armiqsh!»

Pothuaj brenda një sekonde kompania u shpérnda dhe u bë njësh me tokën e qullur. Asnjeri nuk pati kohë tē mendonte se pér tē satën herë komandanti i kompanisë dha variant. Nuk mundi ta mendonte këtë as Gëzim Grezda, që ecte duke turfulluar me vete dhe duke i numéruar çapet një nga një. I quillur, i lodhur, ai i hodhi sytë rreth e rrrotull, pastaj kérceu hendekun nái anën e majtë tē rrugës. Zuri vend prapa trungut tē një lisi. «Kush shtrihet në balte! — mendoi i pushtuar nga një plogështi, e bezdisshme. — Këtu jam mirë. Asnjeri nuk më sheh. As komandanti...» E kishte pisk punën me komandantin. Si

nuk po ia gjente aksoma pikën e dobët atij!? Përpi-kmëria e komandantit të kompanisë ishte një mur që ai nuk po e çante dot. «Dreqi e mori, ai ka për grua kushërirën time, pa le! Dhe miku nuk mohohet.»

U përpoq të shikonte shokët që ishin shtrirë në hendekun e rrugës me shpinë nga ai, po mugëtira e trashë e pasmesnatës nuk e la të shihë qartë asgjë. Vetëm se dëgjoi një zë të ulët që e thirri:

— Gëzim!

Nuk iu përgjigj. Trungu i lisit pas të cilit kishët qëndruar qe i hollë dhe ai sigurisht dukej nga të gjitha anët. «Ama, ç'pozion kam gjetur!» mendoi dhe buzëqeshi hidhur.

— Gëzim, — u dëgjua përsëri zëri i parë në errësirë. — Ulu këtu! Nuk është mirë kështu!

Gëzimi prapë nuk u përgjigj. I Kolës ishte ai zë? Jo. I skuadërkomandantit të tij, Samiut. «Eh, ç'm'u qep dhe ky poeti! — tha me vete i mërzitur. — Ç'dreinqin ka me mua! Sikur u bë kiameti pse po rri këtu!»

— Shtrihu të them! — nguli, këmbë Samiu! — Zbato urdhrin!

Gëzim Grezda pa një dritë të zbehtë elektriku, që shëtitit një çast përgjatë hendekut, në anën e majtë të rrugës dhe lëvizi. «Komandanti», tha dhe u shtri. Përnjëherë ndjeu t'i futej në trup lagështira e tokës dhe u drodh. «Thua të më ketë parë?» Nëpër damarë sikur iu rrökullis një masë aksulli e shkrirë. «Hej, dreq, — murmuriti i inatosur. — Punë të bulkur që po bëjmë. E pse? Kot së koti. Se mos është luftë e vërtetë! — Ndjeu papritur një therje në mes, një si thikë të mprehtë. U shqetësua, por e mori me mend shpejt se e kishte nga lodhja. — Ehu, ky është ndoshta vetëm fillimi!»

Kështu i ndodhë gjithnjë, kur ndiente lodhje.

Ngankohoj me mendime të zymta, të hallakatura... Iu bë se në atë errësirë të thellë të natës dalloj shikimin zhbiues të Sami Kajës dhe ktheu kokën nga ana tjetër. «Eceduroje tashti këtë poetin! Serioz i madh është!»

Vështroi një copë herë atë që ishte në krahun e tij, të djathë. Mezi e njoju. Ishte Kolë Rajca, malësori i gjatë. Qe shtrirë sa gjatë gjéré në hendek dhe me pushkën, që në duart e tij të mëdha ngjante tepër e shkurtër, shikonte diku përpara, përmes errësirës. Gëzim Grezda buzëqeshi duke shtremberuar fytyrën. «Ja, dhe ky shuli s'do t'ia dijë për asgjë! Të gjitha gjërat i merr me seriozitetin më të madh! C'mendje!»

\* \* \*

Gëzimi e ndjeu furtunën që në çastin kur i thanë se e thërriste komandanti i kompanisë. «Aha, më paska parë! Prite tashti edhe breshrin! Kështu ma bëri edhe atëherë, kur ika në fshat...». La rreshtin dhe pas pak u gjend përballë Kujtim Hysit. Vështrimi i tij iu duk shpotitës.

Komandanti i kompanisë ngriti dorën e djathë lart dhe me një lëvizje të prerë uli strehën e shkurtër të helmetës poshtë, gjere mbi sy. Kështu bënte zakonisht, kur inatosej ose kur vërente se diçka nuk shikonte në rrugë.

— Pse nuk e zbatoni detyrën tuaj, shoku ushtar? — e pyeti Kujtim Hysi, me ton të përbajtur. — Nuk e dija, që ju, veç të tjerave, edhe fshiheni.

Gëzim Grezda nuk foli për një çast. Në kundërshtim me parashikimin e tij, furtuna nuk solli bresh-

rin që priste. Përkuqdrazi. Në fjalët e komandantit ai ndjeu një klimë të butë. «Ndoshta s'më ka parë mirë, — tha me vete. — Ndoshta vëtëm dyshoni!»

— Unë?... E keni gabim, shoku komandant! S'kam përse të fshihemi. Nga kush do përfshihemi? — Deri tashëti, indisiplinimin tënd e kam kërkuar gjithnjë të ndonjë motiv i caktuar, të ndonjë shkak i veçantë, kurse sot bindem se i ky ndoshta buroni vëtëm nga... karakteri yt. — — — — —

— Shoku komandant! — — — — —

Po. Ti kërkon t'i shmangeshi gjithnjë detyrës.

Gëzimi uli kokën.

Mbeti një grimë i habitur. Fare pranë tij dalloi siluetën e komandantit të batalionit dhe të një tjetri, që dukej silkur e kishte varur kokën aq shumë, sa mend do t'i binte përtokë. E njoihu menjëherë. Ishte doktori. Ai që... Komandanti i batalionit diç i tha doktorit, pastaj hyri në ujërat e turbullitë të lumit. Pas tij shkoi edhe doktori, pastaj më radhë gjithë toga e parë.

Gëzimi protulloi veshtrimin në të katër anët. Në breng kishte mbetur vetëm ai. Po silkur të shkonte nga e djathta, ku ishte një urë? Solli ndër mend komandanin e kompanisë shokët që me siguri do ta shihnin kur të kalonte urën dhe hoqi dorë. Pas pak e pushtoi inati kundër vetes. E harpoi dhimbjen. Murmurifi ca fjalë të pakuptueshme, pastaj hyri dhe ai, në ujërat e turbullitë të lumit, në mes të valëve të ftotja.

Pushka kërciste. Midis kësmave, që sa vinin e dendësohen, me zhurma pikuese, hynte herë pas here edhe kërkellima e pandërpërre e një mitralozi të lehtë; Ngjitja e vështirë dhe e mundimshme nëpër shpatin e pjerrët thikë të kuotës shtateqind e dy vajzhonte.

Komandanti i kompanisë qëndroi pér një çast prapa një shkëmbi të mbuluar nga dëbora dhe i bëri me dorë skuadrës së parë të spostohej ca nga toga dhe të merrte nga e majta, nëpër shtegun e Pérroit të Verdhë. Skuadërkomandanti kapsalliti pér një çast sytë e tij, të vegjël. Ai pati përshtypjen sikur po e shmagjnin nga sektori më i vështirë i zjarrit. Por, ç'të bënte? Si ta kundërshtonte urdhrin? E udhëhoqi skuadrën andej nga i thanë. Ndërkohë, Qani Shkoza foli me zë të lartë:

— Gëzimi nuk duket, o Sami!

— Qysh!? — ia ktheu Samiu i shqetësuar.

— Që matanë lumit nuk e kam părë më.

— Si është e mundur!?

Sami Kaja ndalloi papritmas dhe e shikoi Qaniun si i hutuar. Cfarë po i thoshtë ky kështu?! Hodhi syty poshtë në lumë.

Trembem se mos lumi... — tha Qaniu, pa e shprehur të plotë mendimin. Atë çast u dëgjuan njëra pas tjetërs ca krisma, të vetmuara pushkësh. Samiu çau përparrë drejt majes së kodrës, që zbardhëllonte nga dëbora. Pastaj shkoi edhe Qani Shkoza. Dhe, pa kaluar vecse disa minuta, toga e parë e kompanisë së dytë zuri e para kreshtën e kuotës shftatëqind e dy. Pastaj arriti atje e dyta, e treta. Në fillim u ndie një fyrinëmarrje e thellë, e ndërprerë, gati si një gulçimë, mandej ajo u normalizua dalfingadalë. Ushtarët e shikuin njëri-tjetrin në sy me një shprehje triumfi në fytërë. Kuota shtatëqind e dy ishte përsëri e tyre.

— Hej! — thirri Qani Shkoza, duke ngritur me dorën e djathë pushkën lart. Deshi të thoshtë digka, por s'dihet pse ndërrroi mendje dhe mbeti pér një çast me pushkën ngritur, si një skulpturë e gjallë parti-zanit të sfondin e bardhë të kuotës së arritur.

— Majave fitores! — thirri Sami Kaja. — Ata që u ngjitën majave, kanë kurdoherë pranë triumfi. Kanë gjithnjë të drejtë të përshëndesin të parët mëmengjesin. — Ama ullo dhëm! hë? — tha Adrian Beli. — Ani mirë, — ia priti Kola. — Burrnja ka fal qen e bardhë, se lahet me djersën e vetë.

— Si, si? — *Was ist los?* — *Was ist los?*

— Djersa e nderon ballin, Adrian. E lamatë dhe  
e sbin më të pastër. I dëgjimi i këtij viti është  
Dy-tre ushtarë qeshën duke keluar pëllumbët  
mbilballin e dërsur! Ndërsa Kola hieshti i menduar.  
Ndërkaq, me sytë hedhur andej nga lumi, Qani Shko-  
za iu drejtua Sami Kajës, që e kishte në krah.

— Ore, pér ideal, nëse nuk ia ka mbathur gjëku-kundi, digj duhet t'iketëngjare atij Gëzimit. Akoma nuk duket! — tha Qaniu.  
— O fare, ore?! — ndërhyri shpejt Qemal Riza.  
— La kam frikën lumit, pér ideal, — iu pergjigj Qaniu. — Djalë mëmërke ai!

**Nuuk ma ha mendja. Gezimi di not, niofta më  
mire nga unë e nga ti**

— Po' atéhere?...

Atéherë... Mbaise ka kalaúar andej nga yura dhe vonohet ca.

- Tö lkhehem -

— Jo, — tha Samiu i meriduan. — Tē: njoftojmē komandantin e kompanisē.

= Shko pra atëherë! Të mos humbasim kohë!

Samū Kaja u nis. Qaniū ngriti paksa lart cepin e pērparmē tē helmetēs, qē i qe zbardhur nga Idēboradhe i hbdhi sytē pērsēri poshtē, nēpēr shpatim e kuo-tēs ishtatēqind e dy.

— Prit, Sami! — tha përnjéherë, me një zë që i ngjante më shumë thirrjes. Ja, tek duket!

Skuadérkomandanti ndaloj e i hodhi sytë andej nga tregoi me dorë Qaniu. Mëngjesi tashmë kishte zbardhur mirë dhe a i e pa qartë. Gëzim Grezdën, që po ngjitej drejt tyre! Dukej sikur po nxitonte pér të fituar kohën e humbur.

— Gëzimi?! — pëshpëriti Samiu!

Shikoi një çast nga shokët. Ata po vështronin po shtë nga ana e lumit. Kishin harruar pér pak kohë lodhjen, të ftohtin dhe déborën që binte pa pushim. Të dukej sikur i thoshin me sy njëri-tjetrit: «More, është-në-të ky Gëzimi, apo jo?»

Pritën në heshtje, gjersa Gëzim Grezda u ngjit sipër në kreshtë.

Komandanti i kompanisë mezi po e përbante veten. Kishte qëndruar një hap larg, përballë Gëzim Grezdës dhe ende pa folur asnjë fjalë, vazhdonte të kërkonte me ngulm sytë e tjetrit, që i dredhonte sa andej-këtej, me një gjest padurimi.

«Duket që është fajtor. Përsëri ky në lavigjin e tij?! Mos i ngre krye në kokë ndonjë mendim i huaj, që i tulat forcat, që i mpin këmbët dhe nuk e lë të ecë njëlloj me të tjerët?»

— Përse u shkëputë nga toga? — e pyeti pas një pauze Kujtim Hysi. — Ku ishe?

Gëzimi uli sytë dhe nuk foli. Në sytë e tij të kalterira një hijsë shqetësimi:

— Përse u shkëputë nga toga, thashë? — përsëriti komandanti i kompanisë. — Nuk i u shkëputa. Unë isha i sëmure. — I sëmure? — Gëzim Grezda ngriti përnjéherë kokën lart, se ndjeu në zërim e komandantit një notë mosbesimi.

— Po. A nuk e patë dhe ju vetë gjatë marshimit...  
Sikur të mos ishte Kola, që më ndihmoi....

— Lëre Kolën mënjanë! Ti pse nuk njoftove?

— Këtë e ka për detyrë skuadërkomandanti! — tha Gëzimi, duke kafshuar buzën, si i penduar përfjalët që shqiptoi.

Komandanti i kompanisë u zu për një çast ngushtë. «Ndoshta ky është vërtet sëmurë, — tha me vete ai, — dhe unë i bie më qafë kot! Po edhe sikur të mos jetë kështu, nuk kam të drejtë ta fyej.»

— Ti duhet ta kuptosh, — i tha me zë të përmbajtur. — **Rreshhti** është disiplinë, grushti, forca jonë. Kur-se ti...

— Më lejoni të largohem? — tha papritur Gëzim Grezda. — Nuk e ndiej veten mirë. Më vonë, po të doni...

— Si?!

Ushtari ngriti supet. Kujtim Hysi e humbi disi fillim nga kjo sjellje e papritur.

— Përsëri ky po njësoj?!

Kur po matej t'i filiste, iu bë në çast sikur i tërhoqi vëmendjen një zë i brendshëm:

«Durim! Partia na mëson kurdoherë t'i trajtojmë me dashuri njerëzit tanë! Edhe kur bëjnë gabime, të tregohemi të matur me ta: Të marrim kosën dhe me kujdes t'u presim barërat e këqija! Kështu! Nëse transhëtë, ku ne stërvitemi çdo ditë, janë vërtet të vështira, të mos harrojmë për asnjë çast se në transhenë e shpirtrave njerëzore kjo punë është edhe më e vështirë. Hyni me durim dhe guxim në to!» Ky zë i ngjante çuditërisht zërit të sekretarit të partisë. Komandanti i kompanisë i uli një çast sytë përdhe.

«Më mirë të mos i flas tashti, — pëshpëriti ai. — Duket që Gëzimin e shqetëson diçka. Të mos ngutem!

Nxitimi e koklavit rrugën e zgjidhjes. Të merrem më tepër me këtë ushtar, t'i qëndroj më afër!»

— Shkoni në rresht! — i tha Gëzimit Kujtimi, duke e vështruar në sy. — Mirë thatë, bisedojmë më vonë.

Gëzim Grezda u largua me hapa të ngadaltë dhe si me pendim drejt transhesë, ku ndodhej toga e tij. Nga sytë e shokëve ai e kuptoi se puna nuk do të përfundonte me aq.

\* \* \*

Ajo nuk ishte mbledhje. Nuk kishte as protokoll, as presidium, as karrige e tavolinë. Tërë kompania kishte qëndruar në këmbë atje, në njérën nga transhetë. Ndërsa Gëzim Grezda rrinte paksa mënjanë, kokulur dhe i mërzitur. E kishte kyçur gojën dhe nuk fliste.

— Hë pra! — i tha Bardh Pepa, që ishte sekretar i rinisë së kompanisë. — Fol! Pse iu shmange togës?

— Unë?

Nuk vazhdoi më tej. Ra sërish një heshtje e zymtë, e rëndë. Moti tani qe zbutur; dëbora binte qetë-qetë mbi supet e ushtarëve.

— Jua them unë juve, mor vëllezër! — u hodh e foli që atje ku ishte Qani Shkoza. — Ai, mor të keqen...

— Prit, Qani! — e ndërpreeu Bardhi në çast. — Unë mendoj se është më mirë të flasë njëherë vetë Gëzimi e pastaj ne. Ndoshta ai ka diçka për të thënë.

— Mirë e ka sekretari, — ia priti Adrian Beli që

andej nga fundi i transhesë. — Hë pra, Gëzimo, fol! Thuaj që e ke kuptuar gabimin dhe ne....

— Dale, dale! — foli përsëri Qaniu, kësaj radhe disi i nxehur. — Ç'do të thotë kjo? Nuk është puna, mor vëllezër, në e ka kuptuar apo s'e ka kuptuar gabimin! Në radhë të parë, ai duhet të japë këtu llogari dëri më një! Pse o, me një «më falni» ta kalojë lumin? Jo, or vëllaçko, jo!

— Hajde pra, fol, Gëzim! — tha me tonin e një gjykatësi të matur sekretari i rinisë.

Gëzim Grezda ngriti një çast sytë dhe i shikoi një pér një ata që folën. U mat të hapte gojën, por aty pér aty sepse ndërroi mendim.

«Jo, — i tha vetes. — Më mirë të mos flas! Njësoj se njësoj. Nuk do të më besojnë. Edhe komandanti i kompanisë nuk më besoi. Pastaj... ndoshta do të qeshin me mua po t'u them arsyen e vërtetë».

Po i vinte të pëlciste nga inati, që e kishte këtakëndisur veten deri në atë shkallë, sa të tjerët ta vështronin ashtu, sikur ai të kishte zbritur aty nga një planet tjetër.

«Jo, jo, — murmuriti sërish me vete — Le të thonë ç'të duan! Le të flasin si t'u vijë pér mbarë! U pa kjo punë tashti! Nuk do të them asnje fjalë.»

— Hë pra, Gëzim, do të flasësh? — përsëriti sekretari i rinisë.

— Jo! — tundi kokën Gëzimi. — Dhe po të doni, më lini rehat tashti! Unë... — Ai heshti papritur, duke e përbajtur me zor valën e zemërimit që e përfshiu në çast.

— E shihni pra, mor vëllezër! — gati sa s'thirri Qani Shkoza, — Gëzim Grezda po mban dhe këtu qëndrim mospërfillës ndaj nesh!

— Thuaje mendimin tënd, Qani! — tha i përbajturi si gjithnjë Bardh Pepa.

— Po e them që ç'ke me të! Ky nuk është i pari gabim i tij. Dikur u tall me Kolën, se demek, sipas tij, Kola është malësor, kurse Gëzimi qytetar. E merrni vetë me mend se ç'del nga ky qëndrim. Më vonë u tall edhe me Samiun. Po, le t'i lëmë këto! Gabimi i sotëm është më i madh nga të parat. E dini ç'do të thotë kjo, mor vëllezër? Me pak fjalë, të braktisësh pozicionin tënd, është barabar si t'i lësh shteg të lirë armikut.

Të gjithë ngritën kryet menjëherë, sikur atë çast t'i kishte pickuar diçka në mish. Mos po rrëmbehej pak si tepër ky Qaniu, ashtu si e kishte zakon? Jo! Pavarësisht nga toni me të cilin foli, ai tha të vërtetë.

— Kështu! — vazhdoi Qaniu. — Unë mendoj se boll jemi marrë deri tani me Gëzimin. U mbush ku-pa. T'u dërgojmë një letër prindërve të tij, t'ua themi një për një të gjitha. Kaq kisha unë, mor vëllezër.

— Mos u ngut! — e mori fjalën Kujtim Hysi. Të gjithë kujtuan se ai do të fliste, sigurisht, edhe më ashpër nga ç'foli Qani Shkoza. Ata e dinin që komandanti i tyre i kompanisë s'të falte as fijen e flokut në raste të tilla, ndaj pritën me kureshtje. Ai vazhdoi:

— Qaniu ka të drejtë kur thotë se ky nuk është i pari gabim i Gëzimit. Dhe, kur gabimi përsëritet, kthehet në faj. Megjithatë, mendoj se propozimi i Qaniut është ca i nxituar. Unë kam bindjen që njëherë për njëherë në asnje mënyrë nuk duhet të veprojmë siç mendon Qaniu, sepse kështu, dashur padashur, mohojmë forcën e kolektivit të kompanisë. Pra, ne vetë duhet të bëjmë shumë më tepër nga ç'kemi bëre

deri tashti me Gëzimin. Të gjithëve mbasse ju kujtohet kur erdhi te ne Gëzim Grezda. Si i thonë fjalës, ai qe gati-gati si një pupël që nuk prekej dot, po dalgadalë e pa se ashtu nuk ecte dot dhe ndryshoi disi. Po nejse!

Kujtim Hysit iu kujtua dita kur qe ankuar në komandën e repartit pér Gëzim Grezdën dhe buzëqeshi hidhur.

— Ne, — vazhdoi ai me atë zërin e tij si buçimë, — nuk kemi punuar sa duhet me Gëzimin. E kemi kritikuar shpesh vërtet, por ashtu kalimthi dhe, në disa raste, ç'është më e keqja, edhe kemi qeshur me veprimet e tij të gabuara. Prandaj dhe mendoj të mos nxitohemi t'u dërgojmë letër prindërve të tij! Kjo do të na skuqte faqen neve, në radhë të parë. Ky ndoshta mund të jetë fishek u ynë i fundit, natyrisht, në qoftë se Gëzimi nuk do ta hedhë hapin njëlloj me kompaninë.

— Tamam pikës, — u hodh e tha fill pas komandanit, Adrian Beli, i shkurtër e kokërrumbullakët. — Shoku Kujtim foli shumë bukur. Në fund të fundit, Gëzimi nuk bëri ndonië hata. Erdhi, do të thoni ju, me një çerek ore vonesë. E çfarë pastaj? T'i shkulim mustaqet pér kaq gjë?! Jo, more!

Dikush qeshi nën zë. Sami Kaja lëvizi një hap përpara në drejtëm të Adrian Belit, pastaj zuri të fliste si gjithnjë, me atë qetësinë e tij të zakonshme.

— Ti, Adrian, s'ke pse e mbron në atë mënyrë Gëzimin. Unë mendoj që ta shikojmë punën ca më thellë, të rrëmojmë me dritën e arsyes! Gëzim Grezda, pa dyshim është shoku ynë, po ama, duam s'duam ne, në disa rrëthana ai ka rrëshqitur e ka humbur disi drejtbeschimin dhe gabimi i tij i fundit nuk duhet parë ashtu si e shikon ti.

«Prite tashti kur t'ia skuqë mirë ky Samiu Gëzimit! — mendoi aty pér aty Adrian Beli. — Poeti ka hak pér të marrë.»

— Po, — vazhdoi fjalën e tij Sami Kaja, — Gëzimi ka rrëshqitur dhe këtë do t'jua shpjegoj vetëm me një zakon të tij, që neve shpesh na është dukur ndoshta zbavités. Ju e dini të gjithë, që ai, kohët e fundit, qdo pasdreke vete heq nga një vizë në trungun e njomë të kumbullës. Dhe kuptimi i këtij veprimi është më se i qartë: «Iku dhe një ditë e lodhshme, e vështirë, e mërzitshme». Me fjalë të tjera, qëndrimin e tij nën armë ai e shikon deri në një farë shkalle si një punë angari. Pra, ka lakra në kokë, të cilat duhet t'ia shkulim se s'bën. Mbështetje se është trim e i ndershëm se, po ta lypë nevoja, jep edhe jetën. Por ama, kjo gjë kërkon përgatitje, gatishmëri.

Sami Kaja heshti pak, pastaj ia qepi sytë Gëzimit. Ky uli kokën dhe aty pér aty ndjeu sikur iu rrokullis diçka përbrenda.

«Pér nder, ky e shkrehu të gjithë karikatorin e tij. I lumtë, përderisa unë....»

— Ore, — tha Qaniu, pa pritur që Samiu të mbartonë fjalën. — Pse o, kaq lehtë do t'i marrim ne punët, a? Ne këtu po flasim pér një faj dhe jo pér një gabim. Faji dënohet, gabimi ndreqet. Samiu, më duket, i ra ca si lehtë e përsipër problemit.

— Ki durim, Qani!

— Çfarë durimi, a derëbardhë! «Më mirë djepin thatë, — thotë Kola, — sesa dreqin brenda!»

— Çfarë?!... — ngriti kokën me vërtik Gëzim Grezda.

Asnjeri nuk foli. Fjalët e Qaniut i turbulluan në çast të gjithë sa ishin më transhe. Ato rrëshqitën me

shpejtësi në mendjet e tyre, të ftohta akull dhe krejtësisht të pazakonshme.

«Si shumë ashpër po flet sot Qaniu! E çuditshme!»

Kolë Rajca u përtyp dhe e kundërshtoi Qaniun me rrëmbim:

— Mos fol ashtu, or ti! — tha me ton qortues. — S'është fjalë që thuhet këtu ajo. Ky Gëzim Grezda është me të vërtetë pak sherrxhi e i pëlqen vetëm mendja e vet, por ani. Ne do ta latojmë se s'bën!

Malësori i gjatë e i urtë, duke folur ashtu, siç nuk kishte folur kurrë deri atëherë, qe skuqur i téri. Gëzimi mezi e vuri re atë ndryshim në fytyrën lëku-rëhollë të Kolës dhe papritmas ndjeu sikur diçka e sëmboi përbrenda. Për herë të dytë e pa veten poshtë, fare poshtë, para mendjes dhe shpirtit të atij njëriu, zakonisht të heshtur, me të cilin ai tallej aq shpesh. Ç'po ndodhë kështu? Fjalët e Kolë Rajcës, të shqiptuara ngadalë dhe si të veçuara nga njëra-tjetra, iu dukën mu si të shtëna pushke. që goditnin në shenjë. Dhe përsëri ndjeu sikur diçka iu thyen përbrenda e sikur iu rrökullis tutje, vrapa një kthese. Mori frymë thellë dhe e shikoi Kolën drejt e në bëza. Një cast më parë i qe trembur fjalës së tij, por... doli i zhgënjer.

U krodh në mendime dhe nuk arriti ta dëgjonte plotësisht Bardh Pepën. I shungulluan në veshë vetëm disa fjalë të shkëputura. apo gjysma fjalësh, të cilat nuk qe në gjendje t'i lidhete.

Ai u përdëndrua dhe e kuptoi që mbledhja kiste mbaruar. Nëpër transhenë e zbardhur vende-vende, tanj endësi heshtja, ndërsa qielli i rimtë, si një xham i turbullt, kishte zbritur aq poshtë, sa dukej

sikur mund ta prekje me dorë. Dëbora vazhdonte të binte qetë-qetë. Fletëzat e saj kristalike kishin qëndisur kapotat e murme të ushtarëve.

Ata dolën njëri pas tjetrit nga transheja dhe për një copë herë Gëzim Grezda e ndjeu veten të vettmar, gati-gati si një bujashkë e hedhur pa mëshirë. E gjithë pamja e tij e kontraktuar, fytyrëskuqur e i vrenjtur, të linte të kuptoje që ai e kishte humbur njëherë e përgjithmonë atë sigurinë e shkujdesur dhe atë krenarinë e vet të njojur. Kokulur, i pushtuar nga një mori mendimesh, që i vinin e i iknin me trokun e bezdisur të një kali çalaman, ai lëvizi disa hapa në të kundërt të shokëve. Ndiente nevojen të rrinte sadopak vetëm. Nuk mund tu bënte dot ballë shikimeve të shokëve, sidomos shikimit të Kolë Rajcës. Sytë e vegjël shpuzë e gjallë të malësorit e vështronin me ngullm dhe sikur e qortonin pa ndërprerje me një butësi të çuditshme, që atij i dukej torturuese. Pa le ai Qaniu! Kurse Sami Kaja i ngjante si një kala e lartë, prej së cilës hidheshin mbi të pareshtur shkëmbinj të mëdhenj e të mprehtë thikë.

«Ja, si erdhi puna! Ata kujtojnë me gjithë mend se kam dashur t'i bëj bisht detyrës. C'është e vërteta, unë desha njëherë por... Nejse! Në fund të fundit, shkaktari jam vetë. S'ma ka kush fajin...»

Pati përshtypjen sikur në goië kishte dicka të hidhur dhe vështyu. Një topitje lodhëse ia kishte mbërthyer tërë qenien, sadë nuk mundte të mendonte rrjedhshëm. Dhimbjen e kishte harruar pothuaise fare, me gjithëse akoma calonte pak. Kishte gozhdë më të madhe nga ajo që i dhanë shokët?... Ajo e kë-

pucës nuk qe gjë para saj. U kujtua se duhej të bën-te çmos të mos binte në sy të tjetërëve që ecte çalë-çalë.

«Në asnjë mënyrë, — tha me vete dhe u drejtua me mundim. — Ndoshta ata do ta marrin sikur unë shtirem. Në asnjë mënyrë!»

Kerkoi njëpër xhepa ndonjë cigare dhe, si nuk gjeti, shau rëndë motin.

«Mirë ma bënë. Ashtu i deshi mushka drutë!» Po ky nuk ishte një miratim. Qe më tepër një kryengritje e sedrës së tij të fyter rëndë. Nga ky shkak, zuri t'i rrihte një nerv në témtha. Përpëlitja nervoze e tij sa vinte rritej. Pas pak iu bë sikur dikush e godiste me çekan në kokë. Ajo që ndodhi kishte qenë përfshirë si një dush përvëlues e marramendës.

«Me gjithë mend e kam tepruar aq, sa të meritoja një dush të tillë, apo?... Po, po, duket që e kam tepruar, po ama jo sa të ngrihet gjithë kompania në këmbë. Në fund të fundit, njeri jam dhe unë. Ah, Sami Kaja, ti, Kolë dhe ti, Qani». I erdhën përsëri në vesh fjalët e Qaniut! «Pse o, kaq lehtë do ta marrim punën ne, a? Faji eshtë faj dhe gabimi gabim. Faji dënohet, gabimi ndreqet. Unë them se...»

Nuk guxoi t'i kujtonte gjer në fund ato fjalë. Iu dukën tepër të hidhura. I erdhi më përmbarë të merrjej me Kolë Rajcën. «Mos fol ashtu, or ti, Qani! S'është fjalë që thuhet këtu ajo. Ky Gëzimi eshtë vërtet palk sherrxhi e i nëlqen vetëm mendja e vet, por ani. Ne kemi përfshirë ta latue mirë e bulkur».

E pushtoi nië zemërim i madh ndaj vetes. Si ngiau kio vunë kështu? Dalngadalë, duke kujtuar Kolën, zuri të aetësohej disi. Po pikërisht atëherë, ashtu si pa u ndier, ai e pa veten papritmas në një ambient krejt tjetër, diku në një rrugë të ndriçuar nga

neonë, që në errësirën e natës ngjanin çuditëriشت me ca si presje të kaltra, të stërmëdha...

«Hello, Gëz!»

Ai po rrinte ulur në bordurën prej betoni të një dyqani rrobash të gatshme dhe po ndiqte me mospërfillje kalimtarët e shumtë që venin e vinin nëpër rrugën e ndriçuar.

«Hej, «tavë kosi!» — u gjallërua Gëzimi.

«Tungjatë!...»

«Tava e kosit» bëri një gjest me dorë, pastaj u ul pranë Gëzimit, në bordurën prej betoni të dyqanit.

«Hë, c'kemi ndonjë të vjetër? Ke kohë që e ke sjellë kokën këtu?»

«Si zakonisht, në gjashtë fiks.»

«Hë, kullote gjë?» — zbardhi dhëmbët e hapi gjënj si një kamare e prishur «tava e kosit».

«Hiç fare.»

«E tmerrshme!» — pëshpëriti pas pak «tava».

«Pse?»

«Sot, në orën dyimbëdhjetë, isha përsëri në komitet.»

«C'të thanë?»

«La ferma!»

«Në fermë?!»

«Jes!» — «Tava e kosit» shqeu gojën sa një kamare. Ai ishte një djalosh rrëth të njëzetave, çehrebardhë e me një hundë të madhe të shtypur.

Nëpër rrugë rrëshqiti një veturë. Dritat e saj të verdha ndriçuan fytyrat e dy të rinjve.

«Dhe do të shkosh?» — pyeti Gëzimi si i hutuar.

«Hahaha, — qeshi papritmas «tava e kosit». — Po, por një herë tjetër.

«Jo, thashë se....»

Gëzimi heshti i mërzitur. Tjetri tha:

«Nuk ka kaluar akoma këtej «Ylli i natës së kaltër?»

Gëzimit i shpëtoi një psherëtimë e zgjatur. Ai u kujtua që shoku i vet e kishte fjalën për vajzën që kishte adhuruar.

«A-ha, — iu përgjigj. — Fluturoi «zogu».

«Si?!»

«Më erdhi fletëthirrja. Do të shkoj ushtar.»

«Je në vete?»

«Oj, jo!»

«Kur do të shkosh?»

«Pas një javë. Flokët... çau, me makinë zero.»

«E tmerrshme! — shfryu mushkëritë «tava e kosit». — Po Meri?»

«E, u!»

«Gëz, a nuk shkojmë e hedhim nga një gotë brrë?»

Ai ngurroi një copë herë, pastaj u nis pas «tavës». Në birrari hodhën nga tri gota. Në të katërtën, «tava» apo Rrik Boçka llomotiti diçka për Merin, demek se para tre muajsh kishte qenë e fejuara e të vëllait të tij dhe se tanë ai qenkësh dënuar të mos rrinte i qetë, sepse ajo e kishte divorcuar padrejtësisht. «O neonë, që nxini!»... Gëzimi pati shqyer sytë. «Ja si na qenka puna!» Kush fshihej vallë, nën lëkurën e këtij Rrik Boçkës, që kishte aq para, sido që nuk punonte, e që e shtynte atë vazhdimisht drejt një vajze, të cilën, në fakt, ai e simpatizonte, po që fillimisht qe sjellë me të në një mënyrë pak a shumë të pahijshme?... Ata u zunë. Asnjëri prej tyre që ishin atje, nuk e mori vesh shkakun.

Gëzim Grezda i ndërpren kujtimet. Në kokë iu ngjit një zemërim i ri. E largoi me mundim «tavën e kosit» nga mendja. Pati përshtypjen se e largoi për-

gjithnjë. Pastaj përfytyroi ditën kur ishte mobilizuar. Në sheshin pranë ndërtesës së degës ushtarake ishin mbledhur shumë njerëz. Ata që përcillnin ushtarët, përshëndetnin me dorë, ndërsa bana e qytetit ekzekutonte muzikë marshimi. Babai nuk kishte dalë ta përcillte. Atë ditë, si gjithnjë, kishte shumë punë. Ndërsa e ëma nuk i qe ndarë. Ajo e porositi:

«Kujdes, hë! Mbështillu mirë dhe mos u lag! Dëgjove? Më njofto pér çdo gjë që të kesh nevojë! Ta dërgoj nëna ty, menjëherë.»

Malkina largohej, kurse njerëzit në shesh duke shin gjithnjë e më të vegjël. Dikush thirri: «Ushtria – garancia! Ushtria – garancia!», dhe në çast e pasuan tridhjetë zëra... Pas disa minutash, gjithçka humbi prapa një kthese.

Gëzim Grezda u kthye dhe u hodhi një vështrim shokëve të tij. Në një rrip toke të futur në ca driza, që e mbronin disi nga era, ata kishin hapur çantat e shpinës dhe po hanin mëngjesin. Një copë bukë të ftohtë, të lagur, dhe një fetë marmalatë. Një copë bukë me marmalatë... Papritur e pakujtar, ai u rrëqeth, pastaj çuditërisht ndjeu se e kishte marrë uria. Një uri që po i gërryente stomakun. Si t'ia bënte? Racionin e tij e kishte hedhur gjatë rrugës, sepse i qe lagur keq, kurse tashti... Me cep të syrit vështroi Kolën. Hamësi i «kategorisë së shtatë», siç e quante ai shpeshherë me shaka Kolë Rajcën, po e përtyppte atë çast kafshatën e madhe të bukës me oreks e energji të pakrahasueshme dhe Gëzimi mendoi se, sikur të kishte edhe ai një copë bukë të tillë me marmalatë, do ta përlante me gjithë qejf.

U inatos me veten që ishte treguar aq hajvan, kur e pati hedhur racionin e tij. U kthye mbrapsht dhe po atë çast solli ndër mend dhe një herë zërin e

nënës. «Deshe gjë, bir?... Mbështillu, të keqen nëna, se ftohesh pastaj! Hë, ylli i zemrës sime!»

Ai u shkund dhe pas disa sekondash gati sa s'thirri: «Jo, nënë! Jo! Edhe këta shokët e mi këtu kanë nënë, edhe këta kanë baballarë, edhe këta kanë shtëpi, të gjithë, të gjithë, kurse ti... Unë...»

Nuk arriti ta përfundonte mendimin e nisur. Përpritmas, dikush e preku lehtas në sup.

— Gëzim!

— Çfarë? — tha Gëzimi gati në një kohë me zërin e tjetrit.

— Pse rri këtu i vetëm?..

— I vetëm... (Ti na bëre shpinën më të butë se barkun dhe tani kërkon të më qash hallin!)... Kot.

— Si kot?...

Gëzimi uli sytë dhe tundi kokën. Sami Kaja foli:

— Shkojmë te shokët! Atje nuk bën kaq ftohtë sa këtu.

— Të falem nderit! Nuk dua.

— Pse? Pse nuk do?

— Nuk dua.

— Mos ngul këmbë! Shkojmë!

Sami Kaja bëri buzën në gaz, mandej këputi një copë bukë nga e tija, ndau fetën e marmalatës më dysh dhe njérën pjesë ia zgjati Gëzimit.

— Merre! — i tha.

— Si?!

— Merre, merre! — tha përsëri Samiu.

— Jo, jo. Të falem nderit! Nuk kam uri.

— Po ti merre një herë, pastaj bëj ç'të duash me të!

Gëzim Grezda ngriti sytë dhe e pa Sámiun drejt e në bebëza. Vështrimi i tij qe i sinqertë. Gëzimit si-kur iu shua aty për aty zemërimi që e kishte push-

tuar pak më parë. Tundi kokën, si të donte të shkëputej nga një ëndërr e keqe dhe përsëri ia nguli sytë Samiut. Ky kishte zgjatur dorën e djathhtë drejt tij dhe i buzëqeshte lehtë e miqësisht.

— Merre, Gëzim! Pas pak do të misemi përsëri pér rrugë dhe ti sigurisht ke uri. Unë pér vete sharrrova.

Gëzimi nuik kundërshtoi më. Gati sa s'iua mbushën sytë me lot. Zgjati me ngadalë dorën përpara dhe ndjeu se diçka iu rrokullis brenda pér brenda vetes, diçka që u grimcua si qelq i hollë dhe humbi diku në hon, sikur të mos kishte qenë kurrë. Buzëqeshi paksa dhe kafshoi bulkën.

## 11

Në një shesh të pjerrët, rrethuar nga ca dushqe të rralla, një këtu, një atje, dëbora kishte shtruar me kohë gëzofin e saj të trashë farfuritës. Ishte ende mëngjes, ora rreth dhjetë. Nëpër shesh kishte pak lëvizje. Dukej atje çadra e madhe e shtabit, brenda së cilës dikush kërkonte me ngulm të hynte në lidhje me dikë. Disa dhjetëra metra larg së parës, binte në sy një çadër tjetër, ajo me kryq të kuq në hyrje dhe më tutje, në mes dyshqeve, ku gurgullonin pareshtur ujërat e një burimi malor, qe ngritur prapavija. Diku prej atje dilte pa ndërprerje tym. Kuzhina fushore e reparat po gatuante ushqim të ngrohtë. Nën oficer Maloja qe vënë me zell në krye të punëve dhe kohë pas kohe thërriste me atë zërin e tij të trashë si bori:

— Pastrojini mirë kazanët! Muço, kujdes kripën! Hë, se na zuri dreka!

Gjithçka fliste për një pritje të afërt. Dhe vërtet, ky ishte rajoni, ku nga çasti në çast pritej të ri-grupohej batalioni. Ai e kishte kryer me sukses pjesën e parë të detyrës dhe tani do të mblidhej aty, që të merrte forca për t'u rihedhur në veprim...

Komandanti i batalionit, Çlirim Shpati, kishte marrë një palë dylbi dhe po vështronët andej nga do të vinin kompanitë. Pranë tij ishte mjeku. Asnjëri prej tyre nuk fliste. Veçanërisht mjeku. Që nga çasti kur kishte folur me sentimentalizëm për rrezikun që e kërcënonte kompaninë e dytë tek qëndronte në transhenë e mbushur me ujë, ai heshtte. Biseda me Çlirim Shpatin në vendkomandën e batalionit dhe pastaj kallimi i lumbit, ishin dy momente të cilat ai s'do t'i harronte kurrë. Ishin dy mësimë të vlefshme, që i kujtonin në të njejtën kohë shijen e hidhur të pelinit në gojë. Pra, megjithëse prania e Çlirim Shpatit i sillte pareshtur kujtimin e asaj bisede, prapëseprapë, ai nuk i ndahej atij. Pa e ditur as vetë pse, shtyhej t'i qëndronte pranë. Kështu ndodhi dhe atë çast, kur Çlirimi ngriti dylbinë dhe zuri të vështronët andej nga pritej të vinin kompanitë njëra pas tjetrës.

— Po duken! — tha komandanti i gjallëruar.

Mjeku i hodhi sytë nga tregoi me dorë komandanti. Në qafën e një kodre dha ballë një ushtar, pastaj një tjetër, një tjetër... Skuadrat, togat dhe kompanitë po mbërrinin me radhë, të qullura, të zbardhura e të lodhura. Me të arritur në shesh, ata fillonin menjëherë nga puna...

Afër drekës, sheshi e kishte humbur përfundimisht atë pamjen e vet të qetë e gati të zbrazët. Shihej aty një qytezë çadrash të vendosura pranë e pranë, me simetri. Midis kësaj pamjeje, që shquhej për rregull, binin në sy veçanërisht ca ndërtesa krejtësisht

të bardha, të vogla, me një arkitekturë të çuditshme. Ishin guvat prej dëbore; brenda tyre bënte fare ngrohtë.

Kishin ardhur të gjitha kompanitë, me përjashtim të së dytës. I shqetësuar nga kjo vonesë, Çlirim Shpati mendonte se ajo kompani, së paku duhej të kishte mbërritur në shesh para gjysmë ore. Ai shikoi për të tretën herë orën. Ajo ishte fiks dymbëdhjetë. Përse nuk po dukej, pra, kompania e dytë?! Komandanti qe përpjekur të lidhej me të disa herë, por s'kishte mundur. Kompania e dytë nuk përgjigjej. «T'i ketë ndodhur gjë?»

— Po, duke menduar që bashkë me kompaninë e dytë ishte edhe komisari, ai e qetësonte veten disi.

— Mjegull! — tha me vete dhe ngriti përsëri dylbinë. E vërtiti sa andej-këtej, por nuk pa asgjë. Mjegulla sa vinte trashej dhe nuk e linte të shikonte as pesëmbëdhjetë-njëzet metra tutje.

— «Po kjo tashti?!... — pëshpëriti, duke shkuar pas radistit, i cili po i ngjitej majës së kodrës përkundrejt, kur arriti atje, e bëri gati radion për punë dhe zuri të fliste:

— «Helmeta»!... «Helmeta»!... «Zjarri»! Si më dëgjon! «Helmeta»!... «Helmeta»!...

Më në fund, u dëgjua një zë i ulët e i largët, aq sa mezi kapej. Çlirim Shpati vendosi përnjëherë kufjet në veshë dhe dalloi i gëzuar zërin e Kujtim Hysit.

— «Zjarri»!... «Zjarri»!... Jam «Helmeta», ju dëgjoj mirë!

— Flisni! — tha shpejt e shpejt Çlirimi. — «Zjarri» ju dëgjon mirë. Flisni!

— Kompania e dytë ndodhet në marshim. Ajo la prapa Qafën e Ujkut dhe tanë po zbret nëpër skërkën e dëllenjave. Kushtet atmosferike — tepër të vështi-

ra. Mjegull e dendur dhe vende-vende — dëborë gjer nё gju. Me ne — komisari.

— Njoftoni vendimin! — tha aty pёr aty komandanti i batalionit.

— Po ruaj forcёn njerёzore, — tha aty pёr aty komandanti i batalionit.

— Po ruaj forcёn njerёzore, shoku komandant!

— Dakord, «Helmeta». Veproni me kujdes! Lidhuni herё pas here me «Zjarrin»!

— Si urdhёron!

Clirim Shpati hoqi kufjet dhe mori frysme lirisht. Po, pas pak, gjithnjё i merakosur, ai ngriti pёrsёri dylbinё para syve. U mundua tё vёshtronte andej nga pritej tё dukej kreu i kolonёs sё kompanisё dhe pikёrisht atёherё, mbi shtrojёn e bardhё tё dёborёs pa njё njolle tё madhe. Jo, njё njeri. Kush ishte vallё? Vёshtroi pёrsёri me vемendje dhe u habit:

«Eshtё nё vete ky!? — murmuriti. — Ku shkon kёshtu, pa urdhёr?»

Ishte mijeku i repartit. Po shkonte drejt kompanisё sё dytё, me njё çantё sanitare nё krah.

Clirimi buzёqeshi i lehtesuar.

## 12

— Lidhuni me «Zjarrin»! Lidhuni me «Zjarrin»!

— Hapat i hidhте nгадалё. Dёbora qe grackё nё atё pjerrёsire tё rreptё. Mjegulla, po ashtu.

— «Zjarrin»! ... — murmuriti rishtas Kujtim Hysi me vete. Qё nga casti kur kishte biseduar me Clirim Shpatin, fjala «zjarr» nuk po i shqitej nga mendja dhe ndoshta vetem atё cast, pёr tё parёn herё nё

jetën e vet, ai i dha rëndësinë e duhur kësaj fjale. Që në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare, kur ishte skënderbegas, e gjer tani që që oficer, ai rrallëherë ishte mësuar ta shikonte zjarrin e të ngrohej pranë tij. Atë e tëriqte më shumë zjarri i lëvizjes. Po kësaj radhe Kujtim Hysi e përsëriti disa herë fjalën «zjarr» vetëm e vetëm për shokët e tij të kompanisë. Ata ishin qullur keq, qenë të lodhur, ndonëse për këtë asnjëri prej tyre nuk ankohej. Pérkundrazi, marshonin gjithnjë përparrë, të heshtur, në njëshkolonë. Dëbora trasej thuajse në çdo hap dhe rruga bëhej e vështirë, gati e pakalueshme.

«Si zuri kaq shpejt dëbora?!... Tashti duhet kujdes, — shtoi ai me vete, duke i hedhur sytë anash, andej nga shiheshin ca thelloma marramendëse, si hinka të stërmëdha. — Duhet të dal menjëherë në krye! Ápo... Jo! Në krye është komisari. Po ruaj më mirë krahu e djathtë të kolonës».

Ekte pothuaj në cep të rrugës së ngushtë këmbësore, e cila merrëj më shumë me mend sesa shihëj. Dëbora e kishte mbuluar atë krejt, aq sa e dystonte fare me shroatin e malit nëpër të cilin zgjatej. Atje... sikur të të shkisnin këmbët...

Komandanti i kompanisë u tendos. Po e shaqtësonte mjaft mjegulla e lagësht dhe e dendur. Ai e hodhi vër një sekondë vështrimin përparrë dhe me vështirësi mundi të vinte re fundin e kolonës. Giithcka përpilhej nga lëmshi i trashë i mjegullës, aq të digjte sytë. E megjithatë, ai e shihte kompaninë me sytë e mendies tek lëvizte, lëvizte, lëvizte... Sa kohë kishin aë ecmën ashtu, përmes dëborës e miegullës? Komandanti i kompanisë ndali papritur në vend i habitur. Mbi savanin e bardhë të dëborës, atij iu duk sikur pa disa pikë gjaku. Dhe vështroi edhe një herë i përqën-

druar. Sytë nuk kishin gabuar. Ato ishin vërtet pika gjaku të piksura mbi dëborë. Ç'kishte ngjarë?... Befas, ai u trondit dhe i nxitoi hapat. Mbi dëborë u dukën përsëri pika gjaku. Një këtu, një atje, ato shfaqeshin larg njëra-tjetrës, në distanca të çrrëgullta, diku thellë.

Ai u përpoq të merrte me mend se ç'ishin ato pika gjaku. Kompania marshonte gjithnjë pa u ndalur dhe ndërkokë asnjëri nga ushtarët s'bënte zë. E pra, midis tyre njëri, sigurisht që duhej të ishte i sëmurë, i gjakosur, ose kushedi... Nuk po i jepte dot anë se ç'kishte ngjarë në të vërtetë. Vetëm se për një gjë ishte i sigurt: Ato pika gjaku që shfaqeshin aty-këtu mbi dëborë, ishin gjak nga trupi i njërit prej ushtarëve të togës së parë të kompanisë; gjak i kuq i piksur. Kush qe, vallë, ky njeri, ky ushtar, ky burrë, që e cte mbi dëborë, me këmbët që i kullonin gjak dhe nuk ndalej??

Komandanti i kompanisë eci disa çaste përkrah kolonës, i përqendruar e i vëmendshëm, por nuk mundi të diktonte cili ishte ai që nuk jepej. Shikoi një hop Kolë Rajcën, Sami Kajën, Qemal Rizën, Qani Shkozën, po sërisht nuk diktoi gjë. Fytyrat e tyre rrëfenin, si përherë, gjallëri e forcë. Vetëm në fytyrën e Gëzim Grezdës ai mundi të dallonte një shprehje dhimbieje të përbajtur, po e hoqi mendjen shpejt prej tij.

«Nuk është e mundur, — pëshpëriti me vete. — Nuk është e mundur të jetë ky!»

Doli në krye të kolonës së kompanisë dhe përnjëherë vuri re komisarin e repartit, që çante përpara duke i tërhequr këmbët pothuajse zvarrë. Dëbora po e kalonte lartësinë e gjurit. Ishte e pamundur t'i hidhje hapat normalisht.

— Kjo skërkë është beterr e keqe, — tha e vuri buzën në gaz komisari.

— Po edhe mjegulla, shoku komisar! — ia ktheu Kujtimi.

Dhe vazhdoi:

— Mbi dëborë, shoh aty-këtu pika gjaku!

— Pika gjaku?! — Fytyra e qetë e komisarit u vrenjt në çast. — Si është e mundur? Ku? — pyeti ai me të shpejfë.

Po tjetri iu përgjigj ndryshe:

— Dikush marshon i plagosur.

— Cili?

— Nuk e di, shoku komisar! Asnjëri nuk ankohet, asnjëri nuk kërkon ndihmë.

— Megjithatë, ju... — Komisari heshti papritmas, pastaj shtoi:

— Lidhuni me «Zjarrin»! Kérkon mjejkun!

— Si urdhëron!

Kujtim Hysi mori menjëherë kufjet, i vendosi në veshë dhe foli:

— «Zjarri», jam «Helmeta»! «Zjarri», jam «Helmeta»! Si më dëgjoni? Marrje!

Nga ana tjetër erdhi zëri i radistit të batalionit.

— «Helmeta»! «Zjarri» ju dëgjon mirë! Marrje!

Pas këtyre fjalëve, foli përnjëherë Clirim Shpati.

— Kompania e dytë vazhdon marshimin, shoku komandant! — tha Kujtim Hysi. — Tani po lë prapa skërkën e dëllenjave. Një ushtar është i plagosur.

— Veproni me kujdes! Mjeku është nisur; — ia ktheu Clirimini.

Komandanti i kompanisë hoi kufjet dhe i transmetoi komisarit fjalët e komandantit të batalionit. Komisari vështroi një sekondë diku përpara i menduar, pastaj tundi kokën, duke vënë lehtazi buzën në

gaz. Kjo donte të thoshte se ai e miratonte qëndrimin e komandantit të kompanisë. Megjithatë, i panojohuri i plagosur duhej ndihmuar, paçka se nuk ankohej. Po cili ishte ai?

Komisari mendoi se mund të qe Gëzim Grezda. Ai kishte parë në transhenë e kuotës shtatëqind e dy Sami Kajën kur kishte ndarë racionin e tij me Gëzimin. Pas kësaj që kishte ngjarë, Gëzimi nuk kishte se si ta jepte më veten para shokëve të kompanisë. Kjo ishte e gjitha. Por.. Nga i binin pikat e gjakut mbi dëborë...

## 13

Ndërkaq, kompania çante gjithnjë përpara. Tek e shihje ashtu të zbardhur, në njëshkolonë, duke ecur përmes mjegullës dhe dëborës që i vinte gjer sipër gjunjëve, të ngjante sikur lëvizte diku jashtë realitetit, si në një ekran filmi me xhiro të ngadalësuar. Shllap-shllap-shllap-shllap! Këmbët mezi shtyheshin përpara. Vetëm në vendet ku dëbora qe më e cekët, ato çliroheshin disi nga puna e tyre e rendë dhe ecnin më shpejt. Shllap-shllap-shllap-shllap!...

Kolë Rajca dukej sikur e kishte ecjen më të lehtë nga të gjithë. Ai çapitej me zhdërvjellësi prej malësori të mësuar me dëboren dhe malin. Dukej sikur kërcentë mbi majat e këmbëve të gjata, duke lëshuar kohë pas kohe një «ah», si ajo e druvarit kur copëton drurin. Një «ah» që i përkiste më shumë zakonit sesa mundit të rrugës.

— Kolë... — tha Bardh Pepa.

— Hë?

— Kujdes! Ti po fluturon.

— Ah...

Kola kérceu pérpara dhe nuk foli. U vu në krye të skuadrës gjithnjë i heshtur. Bardhi mendoi se Kola nuk kishte qenë kurrë kaq gojékyçur sa gjatë asaj rruge. Mos ndikonte gjë këtu ajo letra që i dha komandanti i kompanisë atje lart, në kuotën shtatëqind e dy? Po kush ia çonte, vallë, atë letër Kolës?...

«Diella! — pëshpëriti pér kushedi të satën herë Kolë Rajca.

«Vërtet të ketë shkue në hekurudhë ajo? Po ai xhaxhai i saj?... — Një copë myshik i vjetër malesh ushqehet ende diku, në një skaj të mendjes së xhaxhait. «Burri nuk merr grua në fshatin e vet. Nuk e lë zakoni», — thoshte. Kola qe pushtuar i téri nga kureshtja pér ta lexuar atë letër që ia dërgonte Diella, por as atje lart, mbi kreshtën e kuotës shtatëqind e dy e as tani nuk kishte mundësi ta hapte. Shllap-shllup, shllap-shllup! As që i hynte, në sy bora e trashë dhe mjegulla pérpara. Qe gati ta pérshkonte me një hap thuajse gjithë atë bardhësi lëbyrëse, që të arrinte një çast e më parë tek ajo, Diella, por... Ktheu një 'hop sytë nga Qemal Riza, që ecte pas tij. Atë çast Qemali i foli Qani Shkozës:

— Ta marrë djalli; kohë si kjo, them unë, as pletëtë nuk mbajnë mend të ketë bërë ndonjëherë-tjetër në këto anë.

— Pleqtë? — qeshi Qaniu.

— Ç'ka këtu pér të qeshur? — tha disi i hutuar Qemal Riza.

— Pandeha se po ëndërroje, prandaj. Kë dy ditë që nuk flet pothuajse fare dhe unë mendova se do të më thoshe diçka pér nusen tënde, — e thumboi duke qeshur sérish Qaniu.

— Pér nusen?!

Dhëndri vuri papritmás buzën në gaz. E kishte harruar pothuajse fare që vetëm dy ditë më parë kishte pasur dasmën e tij.

«E çuditshme, — murmuriti me vete, — si më doli nga mendja kështu?» Iu kujtua qdo gjë deri në hollësi. Në dhomën e madhe të shtëpisë ishin mbledhur shumë njerëz, farefis dhe miq. Në krye — ai dhe nusja. Një gaz që ai nuk do ta hiqte kurrë nga kujtesa. Këngë, dolli, urime, pastaj fare papritmas, midis gjithë kësaj hareje, tingujt e alarmit...

— «Po ikën»?

Ai nuk u dha udhë, pa e ditur as vetë pse, atyre fjalëve që i kishte thënë ajo kur po vishej me rrobat e ushtarit. Solli ndër mend vetëm castin kur nusja i pati vënë trëndafilin e bardhë në xhepin e xhaketës, të puthurën e parë të asaj dite të shënuar, pastaj... zërin e trashë si bori të kujdestar Malos.

«Ore, t'u mbylltë, me trëndafil në xhep ke ardhur të luftosh?!»

Shllap-shllup, shllap-shllup! Këmbët mezi çanin nëpër dëborën e trashë. Ngjante sikur ushtarët eonin vetëm me gjunjë.

«Gjysma e së keqes, vo ta dijë vetëm nën oficer Maloja atë punën e trëndafilit. Të tjerët, mbase nuk e panë trëndafilin në xhepin e xhaketës sime. Ishte natë dhe unë po nxitoja», mendoi përsëri Qemal Riza.

— E ke atë trëndafilin e bardhë me vete, apo të humbi? — qeshi papandehur Qaniu.

— Si?! — tha dhe ktheu kokën nga tjetri, Qemal Riza.

«E dikërkë edhe ky punën e trëndafilit! Mos e di gjithë kompania? Hajde mendjefyçkë, hajde! Si, nuk u kujtove ta hiqje më parë!»

— E ke me vete atë trëndafilin e bardhë, thashë? — përsëriti Qaniu.

— Po, — nënqeshi Qemali. — E kam ruajtur me kujdes, si një relike të shtrenjtë.

— Ruaje! — tha Qaniu. — Pranë pushkës — një trëndafil. Gjë e bukur, apo jo? Samiu mund të bëjë ndonjë vjershë të bukur me motivin «Pushka dhe trëndafili».

— Vërtet ashtu, — tha Qemali. — Po, kam frikë se mos ia lë Kolës si stafetë.

— Kolës?

— Po. Atij i erdhi një letër nga Guri i Kuq. Tani për tani atje, në hekurudhë punojnë disa të reja nga malësia e Mbishkodrës. E ke lexuar shtypin?

Qani Shkoza nuk foli. Vazhdoi të çante përpara, duke menduar për Kolë Rajcën.

## 14

Kujtim Hysi i hodhi një sy kolonës së kompanisë. Dukej vetëm kreu i saj, fundi jo. Rruga sajonte një bërrylak në shpatin e kodrës. Te kthesa qe një pjerrësirë e fortë. Një rrëshqitje këmbe një marramendje dhe... Poshtë, në thellomë, nën savanin shndritës të dëborës kishte shkëmbinj të vegjël dhe zall. Ishte shtrati i një pérroi.

Kujtimi mendoi se ajo copë rrugë qe më mirë të kalohej me çap më të shpejtë, prandaj urdhëroi:

— Të rritet tempi i marshimit! Distanca, të shkurtohet!

Ky urdhër shkoi gojë më gojë, gjer tek ushtari i fundit i kompanisë. Jo. Ai mbeti diku, në freshtin

e skuadrës së dytë të togës së parë. Gëzim Grezda mezi ë dëgjoi urdhrin, ndaj Sami Kajës, që e cte para tij, iu desh ta përsëniste:

— Të rritet tempi i marshimit! Distanca të shkurtohet!

«...Të shkurtohet, — pëshpëriti Gëzimi me vete, pas një pauze. — Çfarë të shkurtohet?...»

Ai po e cte kuturu, si një njeri i mbërthyer në ethe, para syve të të cilit qdo send rrudhet, rrudhet, rrudhet.

«Do dhe shumë të arrijmë?» pyeti veten i shqetësuar. Këmbën e djathtë nuk e ndiente thuajse më fare. Para gjysmë ore, ai kishte ndier sikur prej saj rridhët diçka e qullët, por më pas ajo i qe ngurosur. Së paku kështu i dukej atij. Ndërsa tanë i ngjante sikur në vend të këmbës kishte një kërcu. Një kërcu, që ai e tërhiqte zvarrë, zvarrë...

«Pthu! — bëri. — Edhe sikur të mos i ndiej të dyja këmbët, prapëseprapë do të eci. Asnjë hap nuk do të ndahem nga shokët. Nuk ka më hije përmua... Ah!»

Gëzim Grezda, i kujtua paksa me vonësë që duhej të transmetonte prapa urdhrin e dhënë dhe u kthye:

— Të rritet tempi i marshimit! Distanca të shkurtohet!

Mezi foli. Zëmi iu duk si i huaj. Sami Kaja e dëgjoi atë dhe mendoi se Gëzimi nuk duhej të ishte mi-ri. Ktheu një çast kokën prapa dhe pyeti:

— Gëzim, ç'ke?

— Unë?... Asgjë.

— Vertet?

Tjetri nuk iu përgjigj. Samiu heshti i pezmatuar. Sjellja e Gëzimit po e mundonte. Natyra e tij e

butë, zakonisht e menduar, vritej përnjëherë edhe nga ashpërsia më e vogël, edhe nga heshtja më e vogël mospërfillëse e tjetrit.

«Sigurisht, Gëzimi më mban mëri se e kritikova, — mendoi. — Po nejse! Do ta kuptojë që kam luftuar tek ai të keqen dhe jo vetë atë. Si thotë komisari?... Kritika duhet t'i ngajë skalpelit të kirurgut, i cili heq nga trupi i njeriut të keqen, të sëmurën, për të ruajtur të shëndoshën.»

Edhe ai ashtu kishte vepruar me Gëzimin. Qe munduar të mënjanonte të keqen nga shoku i tij.

Sami Kaja ngjeshi kokën midis supeve dhe eci përpara. Ndërkaq, Gëzim Grezda provoi papritur një pickim të egër, që iu ngjit me shpejtësi nga këmbët gjer lart në qafë. Pickimi qe aq i padurueshëm, sa ai e humbi për një çast drejtpeshimin. Iu morën mendtë dhe u anua nga e djathta. Brenda një sekonde, e kuptoi që po gremisej dhe i shpëtoi padashur një si rënkim. Dicëka midis rënkit të thirrjes. Dhe pastaj nuk ndjeu më asgjë tjetër. U gremis.

Sami Kaja ngriu në vend. Qe i pari që e vuri re atë gremisje në të djathtë. Ai nuk pati kohë as të mendonte, as të thoshte gjë. Bërtiti:

— Heeej!

Ata që e dëgjuan, i ngulën sytë menjëherë dhe panë që ai u shkëput si me katapultë prej aty ku ishte e u hodh poshtë, në thellomën e bardhë, që humbi diku, nën napën e trashë të mjegullës....

Gjithçka ndodhi brenda një minute. Komandanti i kompanisë së bashku me komisarin, lanë prapa kreun e kolonës dhe pa humbur kohë iu drejtuanc dy ushtarëve aty pranë, Qani Shkozës dhe infermierit të kompanisë.

— Merrni llitarin! Shpejt!

Nuk qe nevoja të flisnin më. Dy ushtarët e kuptuan mendimin e komandantit të tyre. Ata u lëshuan me nxitim tatëpjetë shpatit të thellomës, duke marrë me vete njërin cep të litarit. Cepi tjetër mbeti i shtrënguar lart, në bërrylakun e rrugës.

Pas disa minutash, dy ushtarët arritën në fundin e thellomës, e njëherë për njëherë nuk panë as gjë. U kthyen të shqetësuar nga e majta. Njëzet-tridhetë hapa larg, si prapa një perdeje tili të zberdhylët, mezi dalluan siluetën e njërit, që ishte përkulur mbi tjetrin.

— Ja, ku janë! — thirrën gati njëzëri ata të dy dhe shpejtuajt andej. Qe një skenë e dhimbshme. Sami Kaja ishte shtrirë mbi dëborë pa ndjenja, me gjoksin të zberthyer e këmishën të grisur. Ishte një grisje, që nuk kishte mundur të shkonte gjer në fund. Një mundim i stërmadh kishte ngrirë në fytyrën e tij të qetë e të menduar. Ashtu i shtrirë, sic ishte, me sytë gjysmë të hapur, ai ngjante sikur kundrontë savanin e bardhë të dëborës. Mbi të i përkulur, i trullosur, me një rrëkezë gjaku të piksur në ballë, qëndronte Gëzim Grezda. Dukej sikur përpinqej të ndihmonte shokun e tij.

— Gëzim! — thirri Qaniu. — Samiu! — pëshpërti i shqetësuar.

Sa vinte ai po qartësohej, po një gjyc i qe ngjitur në grykë dhe nuk e linte të fliste lirshëm. Ajo që dëgjoi Qaniu ishte më tepër një murmurimë, sesa një zë i vërtetë. Po ajo që e habiti më shumë qe diçka tjetër. Qani Shkoza vuri re ashtu kalimthi, që Gëzimi nuk e kishte njëren këpucë, atë të djathët.

«Po ky kur u zbath?»

Ndërkëq, infirmieri qe përkulur mbi trupin e

Samiut dhe e kishte mbështetur veshin mbi krahorin e tij gjysmë të zhveshur.

— Gjallë! — tha i gjëzuar. — O burra, të nxitojmë!

Pa humbur kohë, lidhën litarin për mesi dhe e tërhoqën. Ky ishte sinjali që po fillonin ngjitjen. Litar u tendos në çast. Mandej, që të katër, Qaniu me Gëzim Grezdën mbi supe dhe infermieri me Samiun, zunë t'i ngjiteshin së përpjetës thikë të thellomës, ndërsa ata sipër i tërhoqin prej skajit tjetër të litarit.

## 15

Pas tre çerekë ore, i lëshuan të plagosurit në sheshin e pjerrët, ku ishte pjesa tjetër e batalionit. Gjithnjë me kujdes, nën drejtimin e mjekut që i kishte takuar udhës, i vendosën në çadrën e infermierisë. Atje brenda një sobe të vogël brambullinte një zjarr i lehtë. Katër ushtarët, ndërmjet të cilëve që edhe Kolë Rajca me Qani Shkozën, e ndien përnjëherë afshin e nxehjtë, që u shkriptoi trupin. Ata nuk lëviznin nga vendi. I mbanin sytë qepur te shokët e tyre të plagosur.

— Tani dilni përjashta! — u tha atyre infermieri me ton të ftohtë. — Ju e kryet punën tuaj.

Ata nuk lëvizën nga vendi. Po pas pak takuan në vështrimin e zymtë të komandantit të batalionit dhe dolën të mërzitur.

Mjeku e kreu shpejt vizitën. Ndërkohë, Samiu që përmendur disi, pör ende nuk komunikonte me ata që ishin përreth. Herë pas here, ai lëshonte një si rënkim të mbytur, që mezi dégjohej, ndërsa Gëzim

Grezda vështronë rrëth e rrötull i hutuar. Fytyra e tij e zbehtë, e hequr ca, sikur shprehte faj për atë që ngjau. Tani, ai e dinte mirë se çfarë kishte ndodhur dhe ndoshita nga kjo arsyё përpiquej ta mbante veten, ndonëse dhëmbjet sa vinin e po i shtoheshin më shumë. Plagën në kokë ia kishin fashuar. Infermieri po i vendoste Samiut ca rripa leokoplasti në brinjë.

Në çadër kishte rënë heshtja. Sekretari i partisë, që kishte ardhur aty pas dy ushtarëve të plagosur, dukej i menduar dhe nuk fliste. Në sytë e tij gështenjë pasqyrohej dhimbje, të cilën ai dinte ta përmbannte. Ndërsa Çlirim Shpatin nuk e zinte vendi. I shqetësuar dhe me ballë të rrudhur, ai i hidhët sytë sa te Samiu, te Gëzimi. Pamja e tij e zymtë sikur thoshte: «Nuk duhej të ndodhët kjo. Në asnje mënyrë nuk duhej.» Ia nguli sytë për një qast Kujtim Hysit. Pastaj mjekut, të vetmit njeri në atë çadër që e ruante plotësisht qetësinë, një qetësi të ftohtë, gati indiferente. Çlirim i lëvizti, Mjeku u përkul mbi trupin e Samiut dhe zuri t'i injektonte në venë glukozë të trazuar me vitaminë C. Ngadalë, ngadalë... Pastaj drejtoi shtatin dhe foli:

— Të dy ushtarët kanë nevojë të evakuohen shpejt, shoku komandant! — tha ai, duke u munduar të fshihte prapa këtyre fjalëve gjendjen e rëndë të tyre.

— Doemos, — ia ktheu Çlirim Shpati.

Ndërkaj, sekretari i partisë, Luan Sava, ngriti kokën dhe e shikoi mjekun në sy. Me vështrimin e tij pyetës, i dha të kuptonte se nuk ishte i kënaqur me atë shpiegim të thatë. Ai kërkonte hollësira rrëth shëndetit të të dy ushtarëve. Ndaj mjeku foli sërisht:

— Ky këtu, — ai tregoi me dorë Samiun, — paraqit një kontuzion cerebral dhe një frakturë të bri-

njës së tretë e të katërt, ndërsa tjetri, komocion cerebral të gradës së dytë; ka dhe një plagë të infektuar në këmbën e djaththë.

Ata heshtën. Gëzim Grezda i dëgjoi disi turbull fjalët e mjekut dhe u drodh. U ngrit paksa ndenjur mbi barelë, me një lëvizje të ngathët dhe tha:

— Doktor!...

— Nuk bën të lëvizësh! — ia priti mjeku.

— Unë tanë e ndiej veten mirë, doktor!

Tjetri nuk ia vuri veshin Gëzimit. Gjithnjë me atë pamjen e qetë në fytyrë, siç e kanë rëndom njerezit e këtij profesioni, edhe në situatat më të rënda, ai iu afroa sekretarit dhe komandantit të repartit e u tha diçka mënjanë. Clirim Shpati tundi kokën në çast dhe doli përjashta.

Pas ndonjë gjysmë ore, në hapësirën e ftohtë, mbi sheshin e pjerrët, ku ishte përgendruar batalioni, u dëgjua papritur rrapiçëllima e fuqishme e një helikopteri. Ai u shfaq befas në ajër si një shpendë i stërmadh, pastaj zuri të ulej disa dhjetëra metra larg qytezës së vogël prej çadash, në një copë vend, të zbrazët. Brenda disa minutash përfundoi çdo gjë. Dy çifte mbartësisht, me nga një barelë në duar i morën dy të plagosurit, nga çadra e infermierisë dhe i shpunë me kujdes brenda, në barkun e makinës së airit. Mjeku i shqëroi ata gjer te dera e helikopterit. Kur helika zuri të vërtitej me fuqi, duke ngritur një re të dendur dëbore rrëth e rrötull, ai u mënjanua disa hapa prapa. Helikopteri u ngrit dhe shpejt humbi diku, në hapësirën ngjyrë plumbi të shkrirë të asaj pasditeje nëntori.

Kompania e dytë ndieu një si tronditie. Slikur atë çast iu shkëput diçka. Po pastaj, me një ndjenjë leh-

tësimi në shpirt, ajo u largua. Secili nga ushtarët shkoi në vendin e vet. Qyteza e bardhë ra në një heshtje të thellë.

## 16

Ditët e fundit të nëntorit, për çudi, u zbutën, qielli u bë i kaltër e i pastër, gati si një fajancë e shkëlqyer porcelani. Gjatë gjithë atyre ditëve, kuotën treqind e një e ngrohu dielli i vakët e i kuqërrremtë, që të linte përshtypjen e një pranvere, të vonë. Dëbora po tretej dalngadalë, duke lënë aty-këtu ca vurrata të bardha.

Kurorat e lisave përqark kishin shkundur po-thuajse krejt ngarkesën e tyre të bardhë. ndërsa toka e ngopur me ujë avullonte si me përtesë. Batalioni, që e kishte marrë veten plotësisht pas asaj manovre të befasishme, ngjante sikur u gjëzohej atyre ditëve, kurse kompania e tij e dytë, në gjirin e së cilës mungomin dy ushtarë, Sami Kaja me Gëzim Grezden, nuk e ndiente thuajse fare atë sy dielli të vakët, që përpiaej të ngrohte që atje lart, nga fajanca e kaltër e qelli. Ajo e kishte mendjen gjithnjë te dy shokët e plagosur, prej të cilëve nuk kishte marrë akoma ndonjë lajm, veç atij të komisarit i cili të pasnesërmen e ngjarjes kishte mundur të lidhej me spitalin ku ata ishin shtruar. Gjendja shëndetësore e tyre qe e mirë. Pas kësaj, kompanisë dhe vecanërisht togës së parë iu çlirua frymëmarria. Të gjithë ishin të mendimit se Sami Kaja e kishte treguar veten trim mbi trimat, shpirtgjerë dhe shok i madh, ndërsa Gëzim Grezda... Mendimet e tyre për Gëzimin qenë të ndryshme. Di-

kush rezervohej të fliste për të. Sido që të kishte ndodhur, nuk ishte aspak e hijshme që në ato kushte të flitej për ndonjë gabim të Gëzimit. Dikush tjetër, si bie fjala Qani Shkoza, e kritikonte hapur Gëzimin. Thoshte se nuk ishte aspak e arsyeshme që ai ta bënte atë «sakrificë». Tani të gjithë e dinin, që, gjatë kthimit, Gëzim Grezda e kishte hequr fshehu-razi këpucën e djathjtë nga këmba dhe ashtu, pa u ndarë asnje hap nga kompania, kishte marshuar bashkë me të. Pra, një sakrificë që bëhen pa vend, nuk duhet quajtur trimëri. Kurse ndonjë përpinqej të shikonte në sjelljen e Gëzim Grezdës shpirtin e paepur të ushtarit. Kështu mendonte edhe Adrian Beli. Ai fliste shpesh për një fakt, të cilin ia kishte treguar vetë Gëzimi, kur kishin qenë në pozicionet e «Kreherit të djersës». Gjatë marshimit për atje dhe më vonë drejt kuotës shtatëqind e dy, Gëzimin e kishte munduar së tپerëmi një dhimbje në këmbën e djathjtë. Ky pati qenë edhe shkaku që ai kishte mbetur prapa të tjerëve.

— Le që, ç'të flasim kot! — thoshte Adriani. — Dëshmitar për këtë është Kola dhe Kolën e kemi këtu. Ai e mbarti Gëzimin në shpinë deri në pozicion. Ja, le të flasë vetë Kola!

— Hajde, hajde, — ia kthente Qaniu. — Sipas te-je, vëllaçkó, Gëzimi na dalkérka héro!

— Hero ndoshta jo, por amë në veprimin e tij ka diçka që të shtyn të mendosh se nuk është i atillë siç thua ti.

— Oj!...

— Kur qenka kështu, Adrian, — foli një ushtar tjetër i togës, — atëherë përsë nuk tha asnje fjale, kur e kritikuam në kuotën shtatëqind e dy?

— Dale, dale! — këmbënguli Adriani. — Kjo pu-

në do parë një çikë më thellë! Mbase atij i vinte inat që u vonua!

—Aa, tashti na e mbushe mendjen! — tha Qaniu.  
— Unë thashë mendimin tim.

## 17

Kolë Rajca e ndoqi për një copë herë me sy komandantin e kompanisë, tek po zbriste nga kuota treqind e një, nëpër rrugën që të çonte në fshat. Komendantit i kishte lindur djalë. Në kompani e dinin thuajse të gjithë që ai do t'ia vinte emrin të birit Luftari! Këtë ua kishte thënë vetë. Pra, tani ai po shkonte te Luftari. Telegrami që e njoftonte atë për lindjen e djalit kishte ardhur në kuotë që para tri ditësh; me gjithëkëtë, Kujtim Hysi nuk u largua pa u siguruar për gjendjen shëndetësore të Samiut dhe të Gëzimit.

Ndërsa po e shikonte, Kolës iu kujtua papritmas Diella. Vuri buzën në gaz. Porsa të mbaronte ushtrinë, ai do ta merre Diellën për grua. Nuk do ta shtynë punën asnjë ditë. Xhaxhai i saj, nënkyryetari i kooperativës, nuk përbënte më ndonjë pengesë. Për këtë fliste qartë edhe letra e Diellës.

«Pasha besën, — tha i gëzuar, duke e ulur kapellen mbi sy, — mbaroi kjo punë!»

Solli ndër mend dhe një herë përmbajtjen e letrës, që komandanti i kompanisë ia kishte dhënë atje, në njérën nga transhetë e kuotës shtatëqind e dy.

‘Kolë! — i shkruante ajo. — Jam shëndoshë e mirë. Kështu ma do zemrë të jesh edhe ti. Po ta shkruej këtë letër nga hekurudha e Gurit të Kuq në Pogradec. Kam ardhë këtu me punue për një muej rrreshë, tok

*me disa vajza të malësisë. Këtë javë e morëm ne flamurin e aksionit. Po ti si ia çon atje, në ushtri? Para se të vijsha në hekurudhë, në kryesinë tonë të kooperativës erdhi një letër nga komanda e repartit tand. Ata shokët flitshin shumë mirë për ty, Kolë, dhe unë u gëzova e m'u ba zemra mal. Ma tregoi Lula, sekretarja e rinisë, a të kujtohet? Tjetër s'kam çfarë me të shkrue, vec.... A do të më shkruejsh edhe ti ndonjë letër, Kolë?*

*Diella Mema, sektori i dytë, hekurudha Guri i Kuq. Pogradec.*

Kola u kthye mbrapsht dhe u nis përnjëherë drejt pyllit të lisave. Iu kujtua puna që kishte lënë përgjysmë. Gjatë atyre ditëve të fundit të nëntorit, çdo pasdreke, në kohën e lirë ai shkëputej nga shokët, merrte nëpër një udhë të ngushtë mes lisave, pastaj ndalej në një lëndinëz me bar të shkurtër. Aty qe vendi i tij i punës. Ulej mbi një trung të prerë lisi dhe zinte e gdhendte në dru. Këtë e pati nisur qysh të nesërmen e asaj dite kur kishte marrë letrën nga Diella dhe, me atë durimin që e karakterizonte, ai kishte mundur që brenda një jave të gjente drurin e përshtatshëm. Pastaj kishte nisur gdhendjen me bicak. Tashti po e përfundonte gati plotësisht trupin e ciftelisë.

Edhe atë çast, pasi u ul e punoi për gati një orë, Kola e ngriti lart trupin e ciftelisë, e kundroi nga të gjitha anët, mandej murmuriti me vete i kënaqr:

«Prit dhe pak! Hala s'ke shpirt. Duhen tela!»

Po nuk qe punë e vështirë t'i siguroje ata. Adrian Beli, që e kishte marrë vesh rastësisht se ç'po bënte Kola, e kishte ngacmuar para tri ditësh:

— Telat t'i jap unë, Kolë! Kam tre tela rezervë nga të kitarës, mirë, hë? — Mbaj pér vete, or ti, Adrian, se kanë pér t'u dashtë ndonjëherë. — Pati qeshur malësori me Adrianin.

— Çiftelia është vegël e thjeshtë dhe telat po ashtu të thjeshtë i do. — Ndërkaq, ai vazhdonte punën në dru. Diella nuk i hiqej pér asnje çast nga miendja. Kur ta mbaronte çiftelinë, do t'i binte sa të ngopej pér Diellën. Mbështetje t'ë dhënë një këngë pér të, por... Sa më shumë e mendonte këtë, aq më tepër i dilte para syshtave Samiu. I matur, burrë, shok! Duke punuar, e ndjeu se nuk mund të shkëputet kurrsesi nga shoku i tij, pér t'iu dhënë krejtësisht Diellës. Këngës, dhe Diellës. Dhe ai e vendosi përfundimisht në mendjen e vet.

«Pasha besën, do ta thur një këngë pér ty, o Sami! Nuk di të këndojet dhe aq bukur, por ani! Kënga është këngë dhe ti e meriton».

Kolë Rajca ngriti një çast sytë dhe vështroi përra. Gjatë asaj kohe të lirë i duhej të gdhendte parashtrur në dru. Dhe njëkohësisht të mendonte pér fjalët e këngës. Po, ndërsa pér të parën puna po shkonte si jo më mirë, pér të dytën e ndiente se e ikishte te përzitor. Nuk po i gjente dot fjalët e përshtatshme, ato fjalë, që të linin mbresë tentë gjithë, ashtu siç kishte lënë akti i Samiut.

*Mal më mal e këp më keq  
ç'po i rreh shqipja krahët e vet*

Kaq! Si pën inat, kënga nuk shkonte më tej! Fjalët... Nuk shiuhej, më sa dukej, pér atë, punë! Dhe Kola u mërzit me vete. Si nuk po i gjente fjalët e goditura!... Iu kujtua që edhe atje, në fshatin e tij, të

largët, disa muaj përpëra se të mobilizohej nën ar-më, qe përpjekur të thurte një këngë për mësuesin e tij, i cili mbeti diku maleve midis furtunës, sepse doante ta ikalonte festën bashkë me nxënësit e vet. Po i ati, plaku Dodë, nuk e kishte parë atëherë fort të qëlluar këngën dhe i pati thënë të birit ta linte më-njanë atë. Pra, Kolë Rajca,.. lindur dhe rritur në pragun e një rapsodi të dëgjuar të krahinës, nuk po i ngjiste pikë për pikë të atit. Dhe Kola i ri qe inatosur keq me veten. Nga inati e pati lënë përnjimend këngën. O me ndër, o hiç. Përderisa nuk ishte i zoti...

*Mal në mal e kep në kep  
ç'po i rreh shqipja krahët e vet,  
krahët e vet si shpata e Skënderit,  
zemra e vet si fjala e Enverit.*

*Hej, ta lumsha, moj Parti,  
ç'i dhe tokës këtë rini,  
këtë rini shqipe, si zana,  
Sami Kajë nuk ban ma nana!....*

Kolë Rajca mbeti një çast gati pa frymë. A thua i kishte rënë pikës me këto fjalë? I përsëriti shpejt e shpejt dhe një herë fjalët e rapsodisë dhe pas pak mbeti i kënaqr.

*Mal në mal e kep në kep  
ç'po i rreh shqipja krahët e vet...*

U gjëzua me krijimin e vet, tamam si një fëmijë që e ka humbur për ca kohë nënën, të cilën pastaj e gjen dhe nga kënaqësia nuk di si ta zhysë kokën në gjirin e saj.

Qe përfshirë i téri nga kjo punë dhe njëherë përnjëherë nuk e vuri re Qani Shkozën, që po kthehet nga posta e lokalitetit dhe që tami nxítonte drejt sheshit të repartit. Vetëm kur pas pak dëgjoi zérin e tij të gëzuar që thërriste: «Ej, gazeta! Gazeta!....», ai ngriti kokën dhe buzëqeshi. E la çiftelinë mënjanë dhe u nis drejt Qaniut.

«Diçka ka ky Qaniu që thërret kështu. Ta marrim vesh njëherë.»

Kur doli në sheshin e pjerrët të kuotës treqind e një, rrëth e qark Qaniut ishin grumbulluar disa ushtarë të kompanisë së dytë. Diç pò lexonin. Kola dëgjoi papritur emrin e Samiut.

«Mos është bótuar në gazetë ajo vjersha që ai lexoit atë natën e alarmit?»

U afrova dhe e mori vesh shpejt se hamendja e tij nuk kishte qenë e kotë. Në faqen e tretë të gazetës «Zëri i Rinisë» ata i kishin mbërthyer sytë mbi vargjet e një poezie. Poshtë saj dukej emri Sami Kaja. Ai ndjeu në çast një si rrëqethje të shtatit. Vjersha i kushtohej një ish-partizani, i cili kishte shërbyer përafro tridhjetë vjet me radhë në ushtri si komandant reparti. Kolës i shkoi mendja te ish-komandanti i tyre i batalionit, që tanë ishte komandant i çetës vullnetare të fshatit, atje poshtë. Kishte dalë në pension para një viti dhe...

— E lexove, Kolë? — i tha Adriani.

— E lexova, — u përgjigj Kola i menduar, — Buktur, bukur! — murmuriti Kola.

— Hë, pa shih, këtu, se mos frymëzohesh edhe ti për atë këngën tënde, Kolë! Erdhi festivali. Le që ju

rapsodët keni një damar tjetër, xhanëm! — qeshi Qaniu.

— Disa qeshën: Kolë Rajca solli ndër mend dhe një herë vargjet e rapsodisë së tij të porsangritur në këngë. Poezia e Samiut dhe vargjet e rapsodisë iu dukën sikur i përshkonte një fill i përbashkët: Që të dyja përnjerëzit.

...*Dhe kështu, ai mbeti midis malesh,  
i ndezur yll ndanë pozicioneve,  
si një shkëmb i paepur, si një zjarr rrebesch  
në zemrën dhe tytën e pashuar të batalioneve.*

— Thua ta ketë marrë vesh Samiu për poezinë që iu botua, — tha Bardh Pepa, — Oh, sa do të gëzohet!

— Patjetër që e ka lexuar, — foli një tjetër. — Në spital venë rregullisht gazetat:

— Umë ka-kam dë-dëgjuar se të sëmurët si Samiu nuk i lënë të le-lexojnë gjë, se u bën dëm, — ndërhyri Bilbil Krasta.

— Po Gëzimi? Harrove Gëzimin?!

— Edhe ai si Samiu është. — Po të jetë kështu, atëherë hajdeni t'i shkruajtë një letër! — tha Bardh Pepa. — Mbësia lexon ndonjë infermiere.

— Dakord! Pa e zgjatur, ashtu siç ishin, ata shkuand drejt e në klasën e tyre. Bardhi mori një fletë dyshe nga mesi i fletores dhe u ul të shkruante. E filloj me këto fjale:

*Të dashur Sami e Gëzim!*  
*Dëshirojmë ta ndieni veten gjithnjë e më mirë*  
*nga shëndeti. Ne, këtej nga kuota treqind e një jemi.*

të gjithë për bukuri. Në çastin kur po ju shkruajmë këtë letër, komandanti ynë i kompanisë mungon. Para dy orësh ai u nis për në shtëpi. I ka lindur djalë. Tashët diçka tjetër:

Na fal, Gëzim, që hëpërhë po i drejtohem i vetëm Samiut, sepse kjo lidhet me diçka që ti besoj duhet ta kesh marrë vesh.

Sami! E lexuam sot pothuajse të gjithë poezinë tënde kushtuar shokut Bato, komandanit tonë të vjetër të repartit. Të themi me singeritet, se na pëlqeu shumë. Ti po çuditesh si ndodhi që ajo poezi u botua, përderisa nuk e kishte dërguar në redaksi. Këtë punë e bëri Bilbil Krasta. Një ditë, tek po rregullonte fjetinën, ai e gjeti poezinë tënde nën shtrat. Siç duket, ti e kishe lënë atje atë natën e alarmit. Pra, të urojmë udhë të mbarë në rrugën e gjatë e të bukur të poezisë!

Mbasi i shkroi dhë i lexoi këto radhë, Bardh Peppa ngriti kokën dhe pyeti:

— Dakord jemi?

— Po, — tha Qani Shkoza i entuziazmuar. — Ia ke qëndisur për bukuri.

— T'i shkruajmë gjë tjetër?

— Si jo! Harruat që nga kompania jonë, Samiu dhe Kola u shpallën ushtarë shembullorë?

— Ah, vërtet, — qeshi sekretari i rinisë.

— Prit! — shtoi Adrian Beli. — Shkruaji Samiut që vjershëmë tij e lexoi deri edhe nën oficer Maloja, i cili s'para ia vár dhe aq poezisë.

— Jo, jo. Këtë nuk e shkruajmë, — ia ktheu me seriozitet Bardhi. — Nuk bën: t'i vërtet, mungon. — E psem nuk bëka!? — i ktheu me vërtet. — Sepse ti e kupton që nuk është sjellje e mirë të tallëmi me asnjeri. Pastaj, në qoftë se Maloja nuk

e lexon vërtet poezinë, kjo nuk do të thotë aspak që atij nuk i pëlqen ajo.

- Epo mirë atëherë. Çfarë t'u shkruajmë tjetër?
- Shkruaju se i presim të kthehen sa më parë!
- tha një ushtar tjetër i kompanisë.
- Bukur! Këtë po! — foli sekretari me miratim dhe nisi të shkruante.
- Thuaju edhe që Kola po përgatit një surprizë, — ia priti duke qeshur Qaniu.
- Çfarë surprize?!

— Hajde, hajde. Surpriza është surprizë dhe nuk tregohet asnjëherë. Ç'u mor vesh, po u tregua më parë?

- Eh, dreq, lajthita! — qeshi Qani Shkoza.
- Ta mbyllim atëherë me kaq? — pyeti Bardhi.
- Mirë, — u përgjigjën njëzëri.

Adrian Beli, që do të shkonte të nesërmen në postë, mori kitarën dhe zuri t'i binte. Një mori tingujsh melodiozë pushtuan në çast klasën, pastaj dolën përashta, duke u shpërndarë nëpër të gjithë lartësinë e kuotës treqind e një.

## 18

Disa ditë më vonë, nëpër rrugën që lidhte fshatin me kuotën treqind e një po echin dy vetë. Një oficer fare i ri në moshi, rreth të njëzetepesave, ftyrëqeshur, me një kostum të ri që i rrinte bukur në trupin e tij të drejtë dhe një ushtar i heshtur, me pamje të zbehtë në ftyrë, sikur të kishte lënguar nga ndonjë sëmundje e rëndë. Oficeri mbanite në duar një çantë prej meshini të zezë, nga ato që mbajnë rëndom nëpunësit e dikastereve apo studentët. Ushtari ecte pothuaj gjatë gjithë kohës kokulur. Të linte

përshtypjen e njeriut që kërkonte të arrinte një çast e më parë sipër.

Qe koha afër drekës. Oficeri e shikonte ushtarin me cep të syrit. «Dale, po do mësohém t'i marr edhe unë shpejt e shpejt të përpjetat e thepisura», thoshte më vete.

— Siç duket, të paska marrë malli shumë pér shokët, ndaj nxiton kështu me revan, — i tha oficeri ushtarit.

— Si t'ju them, — buzëqeshi pér të parën herë ushtari. — Edhe më ka marrë.

— Kë qenë më leje në shtëpi?

— Jo.

— Po atëherë?

— Kam qenë i shtruuar disa kohë në spital.

— Ashtu??

Sytë e oficerit u ngulën mbi ushtarin, fytyra e zbehtë është e të cilit dëshmonte shëshit se ai kishte hequr vërtet ndonjë sëmundje.

— Po ju, c'po ju sjell këtej? — e pyeti ushtari oficerin.

— Unë jam gazetar! Dó të shkruaj një reportazh pér repartin e lartësisë.

— Gazetar?

— Po. Ke dërguar ndonjëherë shkrime në gazeten tonë?

— Jo. Unë s'ia shkrep fare asaj punë, po kam një shok timin që shkruan. Mbase mund ta njihni. Ai ka botuar nga dy-tri korrespondencia, megjithëse i pëlqen më shumë poëzia.

— Cili është ai? — pyeti aty pér aty gazetari.

— Sami Kaja!

— Ah, po, e njoh. Pikërisht pér atë po shkoj në kuotën treqind e një, — buzëqeshi gazetari, i kënaqur.

që biseda mori rrugën që dëshironte. — Ai është vërtet i talentuar.

— Edhe unë ashtu mendoj, — tha ushtari. — Por...

Ai e la papritmas fjalën në mes. Gazetari vazhdoi:

— E di, e di, Sami Kaja hëpërhë ndodhet i shtruar në spital. Këtë e mora vesh rastësish sot në mëngjes, në komandën eprore. Po unë po shkoj në kuotën tre-taqind é një pér një çështje që doemos, e plotëson kuardrin që më nevojitet. Është një ngjarje me gjithë mend interesante.

— Çfarë? — pyeti në çast ushtari. Ai u kthye përnjëherë nga tjetri, si ta kishte pikuar diçka.

— Një ngjarje, pér të cilën ia vlen të shkruash, — tha gazetari me buzëqeshje të ciltër... — Ti, besoj, nuk ke qenë në atë stërvitje dhe natyrisht nuk ke se si ta dish. — Oficeri kaloi çantën nga dorë e djathëtë në të majtën, i hënësi sytë pér një sekondë lart, atje ku mezi shquhej kurrizi si prej deveje i kuotës shtatëqind e dy, pastaj shtoi:

— Ca ditë më parë, reparti i lartësisë, domethënë reparti ku shërben ti, ka zhvilluar një stërvitje të vështirë taktiqe. Pikërisht gjatë asaj stërvitjeje, ashtu sikundër ngjet shpeshherë te ne, është manifestuar edhe një herë shprehja më e lartë e guximit, e trimërisë dhe e miqësisë ushtarakë. Më aktin e tij, Sami Kaja e ka treguar më së miri këtë. E kupton?

— Jo, nuk e kuptoja, — iu përgjigj ushtari i menjuar.

— Çfarë ka këtu të pakuptueshme?! — pyeti gazetari i habitur.

— Po ja, siç e thatë dhe vetë ju, kjo është një gjë krejt e zakonshme. Në këtë mes nuk ka aq gjë të vëçantë, që ta marrë gazeta.

— Ah, jo, — tha tjetri, të cilit me sa dukej, i pël-qente nijaft biseda mbi atë ngjarje. — Ndoshata nuk u shpjegova si duhet. Njeriu, kushdo qoftë ai, duhet të dijë gjithmonë të hyjë në thellësinë e gjérave. Ja, p.sh. në këtë rast. Ne jemi mësuar shpeshherë ta kërkojmë heroiken vetëm në majat, vetëm në aktet e jashtëzakonshme, dhe fatkeqësisht, po aq shpesh harrojmë që atë e këmni midis nesh, të veshur me petkun e thjeshtësisë sublime. A nuk është kështu e vërteta?

«Mbase ke të drejtë, mor vëlla, po ku merr vesh kjo, rrudakja ime nga këto!», tha me vete ushtari, pastaj foli:

— Nejse! Samiuni nuk do ta gjeni në repart.

— Kjo nuk prish asnjë punë. Kryesorja është të bisedoj me shokët e tij dhe veçanërisht me një ushtar, me një... Dale! Ah, po! Me Gézim Grerézen!

— Gézim Grerézen?

— Po. E njihni? Sigurisht që duhet ta njihni,

— Jo, jo. Nuk e njoh, Në repartin tonë nuk ka ndonjë ushtar me emrin Gézim Greréza.

— Si është e mundur kjo?! — foli gazetari. — Mos; ndoshta nuk ju kujtohet ky emër?

— Nuk e di; — tha kokullur ushtari. — Jam i sigurt që në repart nuk kemi Gézim Greréz. Gézim Grezda po.

— Eh, tamam ky, — qeshi për një çast tjetri, si i zënë në faj. — Tamam, Gézim Grezda. Mbase unë e shtrembërova disi mbiemrin e tij, po nuk prish punë. Kështu pra, e njihni këtë Gézim Grezdën? Dua të them, e njihni mirë?

— E njoh që ç'ke me të! — nënqeshi Gézimi si me vete. — E njoh si paren e kuqe, por... Ku dreqin e ta-

kova tashti këtë gazetarin? Kërkon të shkruajë, pa le! Prite tashti, kur të fillojë të gërmojë, jo kështu, po ashtu... U pa puna, e mori vesh gjithë Shqipëria kush ka qenë Gëzim Grezda».

— E njoh, e njoh, — nxitoi e tha pastaj me gjysmë zéri. — Po përse ju duhet Gëzimi?

— Çështje zanati, korrektesë, — shpjegoi gazetari. — Ky Gëzimi është njëri nga heronjtë kryesorë të ngjarjes. Me dy fjalë, ka qenë ca i padisiplinuar dhe në kokë ka ushqyer herë pas here ndonjë koncept të huaj, i cili nuk e ka lënë ta hedhë hapin njësh me kompaninë e tij.

— Po, — tundi kokën ushtari, i skuqur papritmas në fytyrë. — Po pastaj?

— Pastaj.... Sami Kaja nuk është pajtuar asnjëherë me qëndrimin e këtij Gëzim Grezdës. E ka kritikuar ashpër; megjithatë, kjo nuk e pengoi aspak që të hidhej me guxim në një hon të thellë për të shpëtuar jetën e atij Gëzimit. E kuptioni se sa e madhe është kjo? Ky veprim sot, në kohë paqeje, të bind plotësisht që nesër, në luftë, ushtarët si Sami Kaja do të vulosin, po të jetë e nevojshme, me gjokset e tyre grykat e armëve të armikut, që të shpëtojnë jetën e shokëvë. Ja, përse ia vlen të përgjithësohet kjo në shtyp. Në gjetin heroik të Sami Kajës për të shpëtuar shokun duket, në fund të fundit, motivi i madh i mbrojtjes së atdheut, i fuqisë së tij të pathyeshme. Apo jo?

— Po, — tundi kokën ushtari, të cilët logjika e gazetarit iu duk bindëse.

— Ja pra, kështu! Ky do të jetë filli që do ta përshkojë tërë reportazhin: Lufta nëpër transhetë e mbrojtjes së atdheut. Nejse! Puna është të bisedoja njëherë me shokët e Samiut, pastaj të gjej patjetër atje atë Gëzim Grezdën.

Ushtari diç deshi të thoshte, po sepse hoqi dorë. Uli kokën dhe, ashtu i heshtur, i nxitoi edhe më shumë hapat.

«Po ky ç'ka?!... — pyeti veten gazetari dhe u bë kurioz. — Dale, dale! Mos është vetë ky Gëzim Grezda?»

Ajo që i shkoi nëpër mend atë çast, e bëri ta shikonte me hetim ushtararin.

«Jo, jo. Nuk ka si të jetë Gëzimi. Ai doli dje nga spitali. Kështu më thanë. Tani, sigurisht duhet të ketë arritur me kohë më repart. Pastaj, përsë do të fshihet?»

Qëndrimin e shqetësuar të ushtarit, ai e shpjegoi me gjendjen shëndetësore të tij dhe aty për aty ndërrroi përfundimisht mendim.

«Sigurisht që është pa qejf dhe nuk ua ka ngenë tanii bisedave», mendoi gazetari. Pas pak vazhdoi:

— Si thua ti, qëndrojnë plotësisht ato që të thashë për atë Gëzim Grezden?

Ushtari nuk foli. Përkundrazi, u inatos papritur. Nuk dante t'ia kujtonin më atë Gëzimin e parë. Ai kishte humbur diku e nuk do të kthehej më. Ndaj nuk e priti mirë që gazetari i solli më mend ngjarjen, që i kujtonte si kishte qenë më parë.

Nga spitali, ai kishte dalë vërtet të djeshmen. Magazinieri ia kishte ngatërruar diku rrrobat dhe mezi ia gjeti pasdite vonë. Kështu, ai nuk u nis dot menjëherë për më repart e as në shtëpi nuk shkoi. Qëndroi pranë Samiut. Pas gjysmë ore, tek po bisedonte me Samiun pranë shtratit të tij, seç iu kujtua dhe u ngrit. Kërkoi leje vetëm për dy orë tek oficeri i rojës i spitalit, i cili u tregua i gatshëm t'ia jepë dhe doli më avtet. U nis për te Meri. Emri i saj i vërtetë ishte Meriban, por dikur ai e thërriste shkurt Meri. Meri i

rrugës me nëon të kaltër... I kishte hipur në kokë ta talkonte dhe t'i kërkonte të falur për atë që kishte ndodhur dikur dhe pastaj t'ia dëftentë fill e për pe ato që kurdiste ndaj saj «tava e kosit». Madje, t'i thoshte se ai vëtë që treguar bûdalla, sylesh e i pacipë që e pati dëgjuar «tavën e kosit». Por, tek ecte, u kujtua se për këto i kishte shkruar asaj dy herë radhazi dhe ajo nuk i që përgjigjur. Po sikur të mos pranonte edhe tashti të bisedonte më të? Ndali hapin dhe qëndrojnë grimë i thenduar.

— Shoku ushtar! — i tha një vajzë dhjetëvjeçare prapa krahëve. — Jeni në kundravajtje. Ecni, ju lutem, nëpër trotuar!

Zëri i vajzës i ngjau cuditërisht si i Merit dhe ai gati u drodh. U kthye nga vajza, vuri buzën në gaz, pastaj bëri c'i tha ajo. Nuk mori nëpër rrugën që të konte të shtëpia e Merit, Shkoi drejt e te vendi ku rrini dikur buzëmbrëmjeje me «tavën e kosit». Nuk gjeti njeri atje. Kalimtarët e zakonshëm të asaj rruge iu dukën sikur tanë ecnin më të qetë. Ai ndjeu një fanë lehtesimi në shpirët dhe pas një minute mori kthesën për të shtëpia e «tavës së kosit». I kishte mbetur 120 lekë borxh dhe donte t'ia kthente patjetër. Donte të mos kishte më pumë me të. Trokiti në portën me numër 52. Pas pak i doli një grua rrëth të pesëdhjetave, me një robëdëshamber të vjetër, nga ata që dikur i mbanin vetëm gratë e pasura të qytetit. Qe e éma e «tavës». Porsa është pa ushtarin, ajo u shqetësua në cast, u bë dyllë e verdhë në fytyrë. Gëzimin nuk e njoftu.

— Deshët gjë? — mezi hapi gojën.  
— Desha Rrikun! — tha shkurt ushtari  
i Rrikut?... → Nga sytë e mëdhenj të gruas, të

cilët ruanin diçka nga tualeti i rendë i dikurshëm, rro-  
dhën papritmas lot. U shkreh në vaj.

— Po c'ë deshe, mor bir? ... Ai... Uf, e mjera unë!  
Gezimi nuk i duroi dot lotët e asaj gruaje. E mori  
me mend si qëndronte puna. I dha leket, pa thënë  
asnjë fjale.

— Hé, si thua? — përsëriti pyjetjen e tij gäzetari.

— Çfare? — Ah, po! Mbérritëm! — gati sa s'thi-  
rri. Sytë e gazetari, u kthyen nga ndërtesa e koman-  
dës së repartit.

— Ajo ndërtëse atje, besoj është komanda apo jo? — bëri ai me dore.

**— Si urdhéron!**

— Epo, tē mirë u pafshim, atëherë! — coi buzën  
në gaz gazetari.

Pas pak, dulke ecur, ai i tha vetes.  
Si i kumpani phan

«Si nuk e pyeta, te paktet, ne c'kompani shembente?»

U kthyē amdej nga po largohej ushtari dne e ondo-  
qi me sy: - Bot - tte G<sup>3</sup> hui mo pedagogy -

— *Nie ist Kunde so frei wie, wie er jetzt ist — für Ärgerlosigkeit* —

Störung d.  
Sitzung 3  
Am Freitag, den 10. Februar 1905, um 10 Uhr —  
Vorstand und Ausschuss, außer dem Präsidenten, waren anwesend.

Gëzim Grezda iu afroa shokëve të tij, druarit  
dhe me një buzagaz të lehtë në fytore. Qe pushtuar  
papritur nga një ndjenjë plogështie, që nuk e shpje-  
gonte dot. Gjatë atyre tri javëve në spital, kishte më-  
nduar që takimi me atë do të ishte i ngrënët, vëllazë-  
ror, por kur iu afroa atyre, nuk iu duk se do të ndodh-  
te pikërisht ashtu. Në poshtë sepse e quante vegen faj-  
tor për atë që kishte ngjare, apo sepse në rrugën për  
në repart takoi atë gazetarin, i cili ia turbulloi disi qe-

tësinë? U skuq, bëri paksa buzën në gaz, pastaj zgjati dorën përpara.

Aty për aty, nuk mori vesh se ç'tha dhe se çfarë i thanë. Vetja iu duk i huaj, pa peshë dhe pa asnje mendim në kokë. Po kjo nuk vazhdoi gjatë. Kur pa që shokët iu hodhën në qafë dhe e përshëndetën me ngrohtësi, e mori disi veten.

— Hë, Gëzimo! — foli i pari Qani Shkoza. — Si e ndien vëten tashti?

— Shumë mirë, Qani! — tha Gëzimi i gjallëruar.

— A u shëndoshe krejt, a? — pyeti Kola, sikur të mos e kishte dëgjuar fare përgjigjen që Gëzimi i dha atë çast Qaniut. Ai e kishte mendjen gjithnjë te Samiu.

— Po, Kolë!

— Hajde, të shkuara, të harruara! — qeshi vesh më vesh Qani Shkoza. — Po Samiu si është?

— Samiu? Do të qëndrojë dhe ca kohë në spital. Ka thyer dy brinjë.

— Me tërë mend?

— Po, — tha Gëzimi me keqardhje. — Samiu ju bën të fala të gjithëve.

— Ne ju kemi shkruar një letër, — tha Adriani. — E morët?

— E kur do ta merrnin, o derëbardhë! — hyri në mes Qaniu. — Ti e postove vetëm tri ditë më parë. Mbësë nesër e merr Samiu.

— Kur dole nga Spitali, Gëzim? — pyeti Bardh Pepa.

— Dje, pasdite vonë, — tha Gëzimi.

— Ishe tashti në komandë?

— Jo. Thashë njëherë t'ju takoja ju, pastaj...

— Sa ditë pushim të dhanë?

— Pushim?... Asnjë ditë. Çfarë pushimi?

— Ou, léri ato! Të sëmurëve si ti, dhe Samiu, u jadin zakonisht nga një muaj leje shëndetësore, ose së paku pesëmbëdhjetë ditë.

— Kú ta di unë, — ngriti supet dhe buzëqeshi Gëzimi.

— Pa-pa nxirre njëherë fle-fletëdaljen nga spitali! — belbzoi Bilbil Krasta, që nuk i besoi aspak Gëzimit.

— Çfarë fletëdaljeje? Nuk kam asnë fletëdalje.

«Pse nuk e grisa, po ë 'mbajta në xhep, dreqi e mori!...»

— Hajde, hajde, nxirre! — zgjati dorën përparrë Adriani.

— Po unë thashë një herë. Nuk më besoni?

— Höpa! — ia bëri Qani. — Mos lëviz! Duart lart!

Gëzimi buzëqeshi, ndërsa Qani Shkoza i kontrolloi aty për aty xhepat e kapotës. Nga i djathti i nxori një copë letër të palosur më katersh. E shpalosi atë dhe e lexoi:

— Hej, jé në vete ti? — thirri në çast. — Akoma ti më ato të tuat? Kë pësembëdhjetë ditë pushim këtu dhe thua që s'më dhancë asnë?!

— Ma jep, ma jep ca! — i tha Gëzimi, me mendimin që ta griste në vend.

— E di ç'ke ti, — ndërhyri Bardh Pepa, — shko e tako njëherë komandantin e kompanisë, pastaj nesër në mëngjes hisu pér në shtëpi! Kë nevojë për pushim...

— Nuk shkoj, Bardh, jo!

— Oui! E pse nuk shkon?!

— Sepse...

Gëzim Grezda e la pa përfunduar fjalën. Shikoi

një çast Qani' Shkozën në sy, pastaj të tjerët me radhë dhë nuk foli.

— Mirë, mirë, — tha Bardhi, duke ia marië nga duart fletëdaljen Qaniut. — Shko tako njëherë komandantin e kompanisë, pastaj shohim e bëjmë!

Zinxher folod i doli. Tashmë vërtet që këtia

19  
o ipostës përkthim i këtij

Porsa bëri disa hapa në drejtim të komandës, Gëzim Grezda ndjeu papritmas të shqetësohej. Iu kujtua gazetari.

«Ku e gjeti dhe ky, të vijë tashti? — pëshpëriti me vete disi i tronditur. — Jo. Më mirë të mos shkoj tashti në komandë. Atje, sigurisht që është ai, dhe unë e gënjeva atë».

Ndali hapin dhe pas një minute u kthyen mbrapsht.

«Ti je Gëzim Grezda?! — iu bë sikur e ndoqi pas zëri i habitur, i gazetarit. — Vërtet ti je ai për të cilin më kanë folur? — Pasoi, një heshtje, gjatë së cilës, në fytyrën e gazetarit u ndeh një notë dyshimi. — Tani e kuptoja. Ajo që kam dëgjuar për ty, qëndron si një e vërtetë e palkundërshtueshme. Përse e fsihni vreten? Nga se keni frikë?»

Gëzim Grezda ngriti kokën lart. Të gjitha këto imori vetëm me mend. U inatos me veten dhe pa e kuptuar se nga po e çonin këmbët, ai bëri tutje nga pylli i lisave. Mendoi të shkonte e të rrinte diku, ku të mos e gjenin, së paku, gjersa të ngrysej, por tamam atëherë kur po hynte në pyll, dëgjoi zhurmë hapash prapa krahëve. U kthyen. Drejt tij po vinte me vrapi Qaniut.

— 'Hej, Gëzim, ku huimbë këshfu? — tha gati me një frymë.

— Pse? — mezi foli Gëzimi.

— Të kërkojnë.

— Kuish më kërkoni?

— Komandanti i kompanisë!

— Komandanti i kompanisë! — Gëzim Grezda u mbush më frymë. — Po' nga e mori vesh që kam ardhur?

— Ku ta di unë! Mbashi të ka parëq tjetri —

Nëngeshi, Njehëre për njehëre pandehu se e thë friste ai gazetari. Megjithatë...

«Prite fashti kur ta marrë vesh e gjithë Shqipëria kush kam qenë unë. Nje...».

Nuk gjeti brenda për brendë vetes aq forcë sa ta shprehte me fjälë ate mendim që nis!

— Epo, hajde pra, luaj këmbët! — tha përsëri Qazni!

Gëzimi u nis. Pas disa minutash trokiti në derën e zyrës, pastaj hyri brenda me një fare druajtjeje. «Gazetari! tha me vete j hutuar aq shumë, sa desh harroi edhe të përhendeste. Kujtim Hysi zgjati për njehëre dorën drejt tij,

— Si je, Gëzim? — foli komandanti, paksa i cuditur nga qëndrimi i hutuar i ushtarit. Mbasi mori përgjigjen, buzëgeshi lehtësisht, pastaj lu kthyë gazetarit;

— Ky është Gëzim Grezda. Shoku është gazetar, — iu drejtua në çast ushtarit.

— Ti qenke Gëzimi?! A zgjati kokën përparraga zetari.

— Po... Unë! — tha tjetri i skuqur në fytyrë.

— Ju njiheni!? — u habit Kujtimi.

— Po, — u dëgjuat zeri i gazetarit. — Ne udhë

tuam bashkë gjér këtu, në kuotë.

— Atëherë akoma më mirë, — tha komandanti i kompanisë. — Në këto kushte, besoj e keni më lehtë të merreni vesh.

— Ndoshta, ndoshta. Por... Si të thuash, unë i kam konsumuar pothuajse të gjitha pyetjet e mia **gjatë rrugës**.

Ra heshtja. Gazetari dukej i kënaqur, ndërsa ushtari sa vinte po e merrte veten. Komandanti i kompanisë vuri papandehur buzën në gaz.

— Tani po e marr vesh si qëndron puna, — tha.

— Me sa duket, Gëzimi nuk t'u shfaq.

— Po, — tha gazetari. — Ai nuk më tregoi se kush ishte, kurse unë... Sidoqoftë, mendoj se deri diku, kishte arsyё ta bënte këtë. Nganjëherë heshtja flet më shumë. Apo jo, Gëzim?

Gëzim Grezda heshti përsëri. Heshtja e tij qe mjafth kuptimplotë për gazetarin.

«Ky ushtar kërkon tashti ta shkelmojë të kaluarën e vet. Përse duhet ta shqetësoj në këtë rrugë të mbarë?»

— Nejse, nejse! — shtoi duke qeshur. — Megjithatë, kjo është interesante, shumë interesante!

Pas kësaj, gazetari nuç foli më. Pa ditur ç'të thoshte e ç'të bënte tjetër, ai shkroi në bllokun e shënimave, poshtë datës 22 nëntor, «Kuota treqind e një». Pastaj buzëqeshi. Buzëqeshën tok me të edhe komandanti i kompanisë me Gëzim Grezdn.

## 20

Gazetari u largua që atë pasdreke. Drita e ditës u shua ngadalë dhe mbi lartësinë e kuotës, nata ra e freskët dhe me një erë, që përkundte lehtazi degëzat e lisave rreth e rrrotull. Në kupën e pafund të qillit

digjeshin qindra mijëra yje të vogla, që regëtihin parështur nga një dritëz e largët valavitëse. Nëpër she-shin e repartit nuk ndihej pothuajse asnjë lëvizje. Kompania e dytë qe rreshtruar si zakonisht për apelin e mbrëmjes. Drita e zbehtë e llambës elektrike mbi derën kryesore të fjetinës mezi e ndriçonte kompaninë nga prapa dhe ndofta nga ky shkak fytyrat e ushtarëve dukeshin edhe më të hequra, edhe më serioze, nga c'ishin në të vërtetë.

Veg Sami Kajës, i cili pritej të vinte në repart nga dita në ditë, të gjithe të tjerët ishin në rreshth. Kolë Rajca, në kohën e lirë nuk e lëshonte pothuajse për asnjë çast nga dora çiftelinë. Pas tri ditësh, në festivalin e folklorit të njësise, ai do të këndonte atë rapp-sodinë e tij, që e kishte nisur që herët për Diellën e pastaj për Samiun. Ishte një këngë e thjeshtë për Partinë dhe për shokët, ku edhe Diella e tij kishte vendin e saj.

*Hej, ta lumsha, moj Parti,  
që i dhe tokës këtë rini!  
Këtë rini shqipe si zana,  
Sami Kajë ka plot në kto ana...*

Ndërkohë, zuri të dëgjohej çast më çast e si bu-qimë zëri i komandantit të kompanisë, që thërriste emrat e ushtarëve, e menjëherë pas tij kumbonte përgjigjja e njohur «Këtu!»

- Adrian Beli!
- Këtu!
- Kolë Rajca!
- Këtu!
- Gëzim Grezda!
- Këtu!
- Qani Shkoza!

— Këtu!

— Sami Kaja!

— Këtu!

— Si?!

Komandanti i kompanisë ngriti menjëherë sytë lart. Kush foli në vend të Samiut? Njëherë për njëherë iu duk sikur që zëri i Gëzim Grezdës, pastaj i Qani Shkozës, pastaj... Mos kishte folur vetë ai...?

Qëndroi për disa sekonda me sytë të ngulur mbi rreshtat e kompanisë. Nuk u mor më me kërkimin e atij-që kishte folur. Zëri që u përgjigj në vend të Samiut që i fortë, tingëlloi disi solemn dhe për disa çaste zotëroi rreth e përqark me pushtet të plotë.

«Sidoqoftë, — tha me vete komandanti i kompanisë, — në rresht nuk mungon asnje. Samiu është këtu. Të gjithë janë këtu.»

Vuri buzën në gáz i kënaqur, pastaj gjithnjë me atë zërin e tij si buçimë, vazhdoi më tej apelin.

## Fund

Halluni, F,

Apeli, Novelë, T, «Naim Frashëri», 1979.

120 f.

B-ka të mëdha

dhe të vogla: 891,983-32

H 22

Tirazhi 6000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

---

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1979